



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 483/ 1 Prot.

Tiranë, më 20.03.2024

V E N D I M

Nr. 77 datë 20.03. 2024

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”², të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr.264 Regj., datë 13.12.2023, paraqitur nga ankuesja znj. R. I, përfaqësuar nga Zyra e Avokatisë "PANAJOTI Law Group" sh.p.k, kundër Këshillit të Lartë Gjyqësor, me pretendimin për diskriminim për shkak të *gjinisë, gjendjes familjare, martesore dhe çdo shkak tjetër*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, parashtrohet se: Ankuesja, R. I, është e punësuar si Specialiste në Sektorin e Administrimit të Prokurimeve, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor që në datën 01 Korrik 2019. Emërimi është bërë në bazë të Vendimit nr.12, datë 18.01.2019 “Për Miratimin e Strukturës Organizative të Administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor sipas skemës, bashkëlidhur vendimit "Njoftim për fillimin e procedurës së transferimit me nr. Prot., 3195 datë 12.06.2019, Vendim nr. 38, datë 24.06.2019, mbi transferimin e përhershëm të znj. R. I, në pozicionin Specialiste e Administrimit të Prokurimeve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, ku ka vendosur... *“Transferimin e përhershëm të nëpunëses civile znj. R.I nga pozicioni “Specialiste - Juriste” në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse, pranë ish Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor.*

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

Ankuesja ka statusin, nëpunës civil, kategoria-niveli ekzekutiv, në pozicionin “Specialiste e Administrimit të Prokurimeve”, në Sektorin e Administrimit të Prokurimeve në Drejtorinë e Shërbimeve Administrative, në Departamentin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Marrëdhënia juridike e punës ka filluar në datën 01.07.2019, me pagë mujore në përputhje me VKM nr. 187, datë 08.03.2017, kategoria III-b. Referuar Urdhrit me nr. 18 datë 26.03.2021, lëshuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me nr. prot 5497/1, datë 26.03.2021, për një ndryshim në urdhrin nr. 93, datë 27.10.2020 është urdhëruar se ...Pjesë përbërëse e strukturës së posaçme për regjistrimin, administrimin, përpunimin e formularëve të vetdeklarimit, në zbatim të Ligjit Nr. 13 /2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike,” emërohet si person përgjegjës znj. R. I-Specialist, Sektori i Administrimit të Prokurimeve.

Referuar Vendimit nr. 443, datë 24.07.2023, lëshuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 157, datë 20.04.2022 “Për Miratimin e Strukturës Organizative të Administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor” i ndryshuar, është vendosur ndryshimi i klasave të pagave në strukturën organizative, bashkëlidhur këtij vendimi, ku ankuesja tashmë nga paga III-B që klasifikohet, klasifikohet në pagën IV-I, duke pësuar ulje në pagë si specialist i Administrimit të Prokurimeve. Faktet e lartpërmendura, vërtetohen përmes praktikës shkresore së sipërcituar, librezës së punës, vendimit të transferimit, bashkangjitur kësaj kërkesë, në cilësinë e provës shkresore, por vlen për tu theksuar se marrëdhënia e punësimit mes ankueses dhe KLGJ (ish ZABGJ — dikur) është më e hershme në kohë dhe daton, që në 2004 (para ndryshimeve strukturore, ligjore, nënligjore, udhërave të brendshëm, vendimeve të transferimit, dikur nga ZABGJ (2004), (sot) te Këshilli i Lartë Gjyqësor që po i citojmë si më poshtë vijon në mënyrë të përmbledhur:

Karrierën si juriste, ankuesja e ka filluar që në vitin 2004, referuar urdhër emërimi nr. 22 prot, datë 08.03.2004, kontratës së punës datë 09.06.2004, lidhur mes Punëdhënësit “ZABGJ” Tiranë dhe punëmarrësit R. N (sot I), ku rezulton se është lidhur kontrata e punës me afat të pacaktuar, ku ankuesja është punësuar në cilësinë e juristes, duke u pasqyruar tërësia e detyrave që do të mbulohehin nga juristi, mes të tjerave, ku përfshihej.... Përgjegjësi për çdo akt që del nga zyra, hartim kontratash, përfaqësim gjyqësor, kodifikime, ligjshmëri për trajtimin e problemeve ekonomike gjyqësore të gjykatave, përgatitje komentarësh, pasurim në vazhdueshmëri të bibliotekës juridike, e përgjegjësi për çdo material ligjor që paraqitet për shqyrtim. Sqarojmë se që nga viti 2004-2014, ankuesja ka punuar si juriste pranë ZABGJ, e më vonë me ndryshimet strukturore ka kaluar si juriste në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme Administrative.

Referuar Akt Deklarimit të Statusit të Punësimit me nr. 37 prot, dt. 03.06.2014 lëshuar nga ZABGJ, në zbatim të Ligjit Nr. 1527/2013 “Për Nëpunësin Civil”, znj. R. I, deklarohet “Nëpunës Civil” në pozicionin “Specialist Jurist” në Sektorin e Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse të Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor. Siç më lart citohet, rezulton se gjatë kësaj kohe ka pasur ndryshime përsa i takon cilësimit juridik nga nëpunës i administratës publike me Kod Pune në Nëpunës Civil sipas ligjit përkatës, kategorizimi në pagë III-B, etj... Vlen për tu theksuar se juristi i

punësuar me kategorinë e pagës (III-b), sipas përshkrimit të detyrave funksionale në Kontratën e Punës ka mbuluar aktivitetin juridik jo të një sektori ku ishte pozicionuar gabimisht, por aktivitetin juridik të gjithë institucionit të ZABGJ-së. Kjo punë ka vazhduar pa ndërprerje për 10 vite rresht. Ky fakt, vërtetohet nga moria e akteve të ndryshme, përgatitur dhe trajtuar nga juristi, të cilat një pjesë i disponojmë dhe një pjesë ndodhen në institucion, çka vërteton aktivitetin e zhvilluar të punës në ZABGJ nga juristi i saj. Si rrjedhojë e kësaj, kishim një mospërputhje mes pozicionimit të saj de jure, punës që realizonte de facto, trajtimin me pagesë, marrjes përsipër të të drejtave, detyrave, përgjegjësi, e cila nuk duhej të ishte III-B, por duhej të ishte II-B apo II-2 sot.

Përsa më lart citohet, kërkuesja është ankuar vazhdimisht në rrugë administrative (nga viti 2006 e në vazhdim), duke parashtruar kërkesa ankimore pranë Drejtorit të Zyrës, Bordit, po ashtu, është drejtuar me kërkesa për rishikimin e kategorisë së pagës dhe pozicionit të punës (në periudhën kohore 2012-2013), kërkesa këto që ndodhen pranë arkivit të ZABGJ, i transferuar aktualisht pranë KLGJ, duke kërkuar vazhdimisht klasifikimin e përshtatshëm të pagës në raport, me sa më lart citohet (duke pretenduar se meriton të trajtohet me pagën II-B), dhënien e pagesës shtesë për gradën shkencore që ajo dispononte "Doktor" sipas ligjit, ngritjen e saj në detyrë, duke evidentuar që përmes lëvizjeve paralele, lëvizjeve paralele, kualifikimeve përkatëse, vitet e vjetërsisë në punë, kontributin ndër vite, etj... Ky fakt nuk u mor asnjëherë në konsideratë në asnjë periudhë të parashtrimit të kërkesave ankimore, 2004-2014 -2019-2023, të cilat ndodhen të depozituara dhe administruara pranë KLGJ).

Mostrajtimi i saktë me pagën që meritonte sipas kualifikimeve të saj, apo punës që ajo kryente gjatë gjithë kohës pranë ZABGJ dhe sot KLGJ, jo vetëm që solli diskriminimin e saj në pagë, por njëkohësisht dhe përsa i takon ngritjes së saj në detyrë, në raport me punën që kryente, statusin e saj, emërimin e saj si "Shefe sektori", apo pozicione të tjera ku shfaqte interesim, pozicione që sipas çmuarjes së saj i takonin, në përputhje me ligjin, lëvizjet paralele, kualifikimet profesionale, vitet e vjetërsisë në punë, rezultatet pozitive ndër vite, kontributin e punës ndër vite që nga fillimi e gjer më sot, apo të faktit që gjatë gjithë kësaj kohe nuk ka marrë vërejtje disiplinore asnjëherë, etj.

Referuar kërkesës ankimore datë 28.06.2019 " Kërkesë për rishikim vendimi nr. 38 datë 24.06.2019" për transferim të përhershëm në pozicionin Speciliste e Administrimit të Prokurimeve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kërkuesja parashtrroi faktin e kategorizimit të padrejtë të pagës dhe pozicionimit të saj, duke kërkuar që pagesa lidhur me profesionin e Juristit të kategorizohej si pagë II-b dhe jo III-b, pasi kategorizimi i padrejtë sillte pasoja të dëmshme jo vetëm financiare, por njëkohësisht dhe përsa i takon ngritjes në detyrë.

Nga ana e kërkueses është kërkuar që të mos ndryshohej në mënyrë të njëanshme kontrata fillestare e punës (2004) si Juriste pranë ZABGJ, pasi ndryshimet strukturore nuk duhej të cenonin as pozicionin e saj të punës e as pagën, si rrjedhojë e vendimeve arbitrale të njëanshme e të padrejta, duke transferuar (apo ulje në detyrë) nga Jurist insitucioni në Specialist Prokurimesh të departamentit. Përmes shkresës së sipërcituar ankuesja ka kërkuar, revokim vendimi, dhe emërim në sektorë të përshtatshëm në raport me pozicionin e punës, kualifikimet, trajnimet, eksperiencën,

vjetërsinë në punë, por mbi të gjitha të faktit juridik, se në atë periudhë kohore kishte mjaft sektorë të pambuluar dhe që kishin nevojë për staf të kualifikuar.

Referuar kthim përgjigje me nr. 319575, datë 01-07-2019 të lëshuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, rezultoi se ... citohet përmbajtja e shkresës ... “Ky pozicionim është bërë si rrjedhojë e faktit që nga ana e kërkueses janë ushtruar funksionet e specialiste-Juriste, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse në ish ZABGJ dhe se gjatë ushtrimit të detyrave mes tjerave është marrë dhe me prokurime dhe se në kuadër të ligjit, çdo emërim është bërë në përputhje me ligjin, dhe VKM nr. 125-2016”.

Përmes praktikës së sipërcituar, pasqyrohet fakti se vazhdimisht, që në vitin 2019 si rrjedhojë e procedurave të transferimit në KLGJ pas ndryshimeve strukturore që solli Reforma në Drejtësi, ku tashmë bazuar VKM nr. 125, datë 17.02.2016 “Për transformin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civile, ankuesja u pozicionua si “Specialiste e Administrimit të Prokurimeve” në KLGJ, si dhe referuar Urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm Nr. 18, datë 26.03.2021, “Për një ndryshim në urdhrin 93, datë 27.10.2020 “ Për caktimin e personave përgjegjës nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative për Strukturën e Posaçme për regjistrimin administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit”, është caktuar njëkohësisht dhe si person përgjegjës përsa më lart citohet, duke vijuar më tej me rritje në ngarkesë pune, përgjegjësish por jo page, përkundrazi (ulje page nga III-B në IV- I) si dhe pozicionim pune, që sipas ankueses në vend që të ngrihej në detyrë, ishte ulje në detyrë në mënyrë të njëanshme, në kundërshtim me ligjin. Kjo është arsyeja se vazhdimisht nga ana e kërkueses është proceduar me ankesa administrative, duke pasqyruar faktin që kërkonte pozicionim të saktë të saj, lidhur me kualifikimet, punën që ka kryer në këtë institucion, vjetërsinë e saj, trajtimim me pagë dinjitoze, etj, por këto ankesa administrative nuk morën një zgjidhje në raport me kërkimet.

Për të vërtetuar pretendimet tona (përveç ankimeve të sipërcituara), sjellim në cilësinë e provës shkresore dhe aktet, si më poshtë citohet. Kërkesë datë 13-07-2022 nr. Prot., 3992, datë 13.07.2022 “Shtesë page për fitimin e gradës shkencore Doktor”.

Kthim përgjigje me nr. 3992/I prot., datë 27.01. 2022 me anë të së cilës sqarohet fakti se referuar VKM nr. 187, datë 08.03 2017, paga shtesë aplikohet për pagat II-b, si dhe miratohet për institucionet e pavarura nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, ku grada, kualifikimi përputhen me vendin e punës, ndërkohë si rrjedhojë e transferimit si Specialiste e Administrimit të Prokurimeve, paga është III-b, përsa i takon kërkesa për “këshilltar ligjor ” aplikohet sipas ligjit.

Ankim Administrativ datë 17.10.2023, të depozituar dorazi.

Ankesë Administrative datë 23.10.2023 në rrugë elektronike, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm pranë KLG, I.Kërkesë informative për pagë datë 01.10.2023 drejtuar Departamentit të Financës. Kthim përgjigje nga ana e tyre me datë 24.10. 2023. Shkresë kthimin përgjigje me nr. 532/I prot., datë 31.10.2023, lëshuar nga KLGJ, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm pranë KLGJ, nga anë të së cilës sipas tyre është proceduar në përputhje me ligjin.

Vlen për tu theksuar, se detyrat e saj pranë këtij institucioni kanë qenë të shumta, duke qenë të tilla dhe përgjegjësitë në varësi të detyrave që ka marrë përsipër dhe i ka realizuar me sukses, fakt i vërtetuar me anë të “Raport Vlerësim pune” dhe vërtetime të lëshuara ZABGJ dhe KLGJ, në të cilët pasqyrohet fakti se ankuesja gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës, ka marrë përsipër realizimin e shumë detyrave, përgjegjësi dhe mbi të gjitha nuk ka pasur asnjë vërejtje disiplinore gjatë tërë kohëzgjatjes së punës 2004-2014 dhe 2014 e gjer më sot (vërtetuar me anë të Raport mbi punën e kryer nga Juristi ZABGJ Nr. 2, dt 15.10.2007. Raport “Vlerësim pune -2019. Vërtetime me nr. 519 prot, datë 16.10.2015, lëshuar nga ZABGJ. Vërtetim nr. 75 prot, datë. 10.10.2017 lëshuar nga ZABGJ. Formular Vlerësimi pune viti -2019. Vërtetim nr. 1101 prot, datë 18.02.2019 lëshuar nga KLGJ. Vërtetim nr. 5695 prot, datë. 01.11.2022 lëshuar nga KLGJ. Vërtetim nr. 5102 prot, datë. 04.10.2023 lëshuar nga KLGJ. Sqarojmë se aktet e sipërcituara, i paraqesim në cilësinë e provës shkresore duke theksuar faktin se paraqesim vetëm aktet e sipërcituara, i paraqesim në cilësinë e provës shkresore, duke theksuar faktin se paraqesim vetëm aktet që disponojmë, duke parashtruar përpara jush, që pjesa tjetër e akteve ndodhen pranë KLGJ, e për rrjedhojë duke kërkuar që të merren në cilësinë e provës nga ana juaj për pamundësi objektive disponimi.

Ankuesja nga ana e saj gjatë kësaj periudhe kohore ka aplikuar apo ka shfaqur interes për ngritje në detyrë si “Shef i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve” fakt i vërtetuar me anë të kërkesës datë 06.10.2023, referuar e-mail të datës 27.10.2023 dërguar nga ana e Burimeve Njerëzore është skualifikuar pasi nga ana e kërkueses nuk është proceduar me dorëzim formulari për vlerësim në punë, për periudhën e fundit janar—qershor 2023, por vetëm për periudhat deri në korrik—dhjetor 2022. Përsa më lart, për shkak të mospërmbushjes së një prej kushteve minimale dhe mosparaqitjes së dokumentacionit të plotë kërkuësja është skualifikuar nga konkurrimi.

Sqarojmë se arsyeja e skualifikimit është e paligjshme, e pabazuar në prova, kriteret e shpallura dhe nuk qëndron as *de juro* dhe as *de facto* pasi, së pari nga Departamenti i Burimeve Njerëzore, nuk është kërkuar vlerësimi i fundit në punë, por dhe nëse do të ishte kërkuar, nuk është kriter klasifikues, sepse nga ana e këtij Departamentit u morën në dorëzim dokumentat. Së dyti, dokumentacioni i kërkuar është pjesë përbërëse e dokumentacionit që disponon vetë Departamenti i cili e ka kërkuar, ndaj paraqitja apo jo e këtij dokumentacioni (pavarësisht se nuk ishte pjesë përbërëse e dokumentacionit që duhej të paraqitej) nuk mund të merret si kriter skualifikimi nga gara, pasi kërkueses nuk i është thënë paraprakisht ky fakt, por njëkohësisht është dokumentacion i cili ekziston brenda vet strukturës, e mbi të gjitha kërkuësja ka paraqitur vërtetime që pasqyrojnë faktin që ndaj saj nuk është marrë asnjëherë vërejtje disiplinore, si dhe vlerësimet në punë ndër vite të realizuara nga ana e saj kanë qenë pozitive gjatë gjithë kohës. Sqarojmë se skualifikimi për mosparaqitje të dokumentacionit “vlerësim për periudhën janar-qershor 2023” ishte i qëllimshëm, për t'i mohuar të drejtën e pjesëmarrjes në garë. Ky fakt pasqyrohet më së miri në praktikën shkresore, korrespondencën përtase (shkresore-elektronike) bashkangjitur kësaj ankese në cilësinë e provës shkresore kam pasqyruar kontestimet lidhur me skualifikimin e paligjshëm, të padrejtë, diskriminues, kundrejt ankueses.

Njëkohësisht nga ana e ankueses është proceduar dhe me aplikime për pozicionin e Këshilltarit në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershëm në Këshillin e Lartë Gjyqësor datë 27.10.2022, por që dhe sot nuk më është kthyer përgjigje zyrtare lidhur me këtë shprehje interesi.

Përsa më lart citohet, konstatohet qartazi se nga ana e ZABGJ, KLGJ, vazhdimisht janë cënuar të drejtat e ankueses në mënyrë arbitrare, të njëanshme, duke shkelur ligjin, të drejtat e ligjshme si nëpunës civil, sa i takon punësimin në pozicione pune adeguate në raport me kualifikimet e saj, vjetërsinë në punë, eksperiencën e saj, kontributin që ka dhënë pranë ish ZABGJ sot KLGJ, që nga 2004 e deri më sot, duke emëruar persona të tjerë që nuk kanë pasur kriteret, kualifikimet, eksperiencën e duhur të punës.

Ankuesja vazhdimisht është ndjerë e diskriminuar në raport me pjesën tjetër të stafit, pasi përtej përpjekjeve të saj personale të shtrira në kohë, përsa i takon ngritjeve profesionale, akademike, perfeksionimit të saj si eksperte fushe, rritjen e ngarkesës së punës, është ndeshur me barriera nga ish ZABGJ dhe KLGJ, përsa i takon pozicionimit të saj në struktura përkatëse adekuate, duke ju mohuar e drejta e konkurrimit të ndershëm e në përputhje me parimet e shërbimit civil, kualifikimit në bazë të ligjit, dhe pozicionimit të saj në raport me kualifikimin e disponuar.

Skualifikimet e padrejta ndaj saj në procedura konkurruese, kanë sjellë cënimin e interesave të saj të ligjshme jo vetëm për punësim adekuat në përputhje me diplomimin, vjetërsinë në punë, profesionalizimin e ushtruar ndër vite, por dhe të drejtën e pagës, apo pagesës shtesë në raport me kualifikimet e saj, apo gradën doktor shkencash.

Përmes praktikës shkreore të sjellë pranë jush, çmojmë se ankuesja është diskriminuar, pasi nga ana e ZABGJ, KLGJ, asnjëherë nuk u morën në konsideratë pretendimet e saj, por përkundarazi si rrjedhojë e ankesave të saj të ligjshme nga ana e tyre ndërmereshin veprime ligjore në kundërshtim me ligjin, duke u ndryshuar në mënyrë të njëanshme, pozicioni i punës, struktura, emërtimi, detyrat, paga, në dëm të interesave të saj ligjorë, ekonomike, të punës, duke mos e marrë si palë kontraktuale, duke i cënuar të drejtat për tu dëgjuar, shprehur, lidhur me transferimet e paligjshme që sollën dhe ndryshim të njëanshëm të kontratës së punës, shoqëruar me ulje në detyrë, pagë, trajtim dhe të drejtës së ligjshme për tu ngritur në detyrë.

Si rrjedhojë e veprimeve direkte apo indirekte të tyre, kërkuesja është diskriminuar në mënyrë të paligjshme dhe nga procedura të mëtejshme konkurruese për ngritje në detyrë, duke e skualifikuar në mënyrë të qëllimshme, për të mos marrë pjesë në konkurs e për pasojë të mos zgjidhej (pasi sipas çmuarjes së saj bazuar në kriterin akademik, profesional, vjetërisë në punë, formularëve të vlerësimit, rezultateve në punë, ishte një kandidat e përshtatshme për tu përzgjedhur dhe mënyra e vetme për të mos fituar ishte gjetja e një shkaku skualifikues edhe pse duke shkelur ligjin.

Kërkuesja çmon se gjatë gjithë kësaj kohe ka depozituar kërkesa, shfaqje interesi për ngritje në detyrë, marrë pjesë në procedura konkurruese dhe në vend që të zgjidhej ajo, janë zgjedhur persona të tjerë, që nuk kanë as kualifikimet e saj, as eksperiencën, vjetërsinë, etj.

Sa më shumë që kërkuesja ankohet, aq më shumë rritet diskriminimi ndaj saj, duke e skualifikuar nga çdo procedurë konkurruese, duke shkelur ligjin përsa i takon klasës së pagave, duke e ulur në detyrë në mënyrë të njëanshme.

Kërkuesja çmon se ky diskriminim vjen si rrjedhojë e të qenurit femër, e martuar me shtetas të huaj, përkatësie etnike tjetër, apo faktit të ankesave të vazhdueshme, të realizuara nga ana e saj për cenim të të drejtave të saj të ligjshme.

Kërkuesja ndihet e diskriminuar, pasi pavarësisht ngritjes akademike, profesionale, vjetërsisë në punë, rezultateve të mira në punë, korrektësisë, ndershmërisë, asaj nuk i jepet mundësia për ngritje profesionale në raport me kualifikimet e saj, por përkundrazi duke u cënuar dhe duke përzgjedhur persona të tjerë që nuk i kanë cilësitë, kriteret, kualifikimet e saj dhe kjo situatë ndërlikohet, vështirësohet vit pas viti, duke i rrezikuar të drejtën e saj për punësim, vlerësim, pagë dhe jetë të shëndetshme.

Përmes veprimeve dhe mosveprimeve të realizuara nga KLGJ, kërkuesja nuk ndihet e barabaratë përpara ligjit apo barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në ngritje profesionale si të tjerët, duke kërkuar kështu mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje, që nxit diskriminimin kundrejt personit të saj.

Çojmë se kërkueses i është cënuar e drejta për punësim, si rrjedhojë e dallimeve, kufizimeve ose përjashtimeve në pjesëmarrje në konkurrim apo përzgjedhje, që ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve; c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale.

Nga ana e Punëdhënësit nuk është zbatuar apo mbrojtur, nxitur parimi i barazisë dhe të ndalimit të çdo lloji diskriminimi; nuk janë marrë masat e nevojshme, përfshirë dhe masa disiplinore, për mbrojtjen e punëmarrësve nga diskriminimi dhe viktimizimi.

Argumentimi ligjor

Çojmë se kërkesa jonë është e bazuar në prova dhe në ligj për arsyet që po parashtrijmë, si më poshtë vijon:

Së pari: Çojmë se nga ana e punëdhënësit (ish ZABGJ sot KLGJ) gjatë gjithë kohës, kërkueses i janë shkelur të drejtat ligjore, si përsa i takon pagës në përputhje me detyrat që realizonte pranë ish ZABGJ, ashtu dhe përsa i takon mundësive për rritje në detyrë, duke qenë vazhdimisht në mënyrë direkte apo indirekte, subjekt i diskriminimit për arsye të gjinisë femërore, guximit të shfaqur gjatë gjithë kohës duke u ankuar në rrugë administrative, për shkak të martesës me shtetas të huaj dhe mohimin e të drejtës për t'u ngritur në detyrë si rrjedhojë e kësaj, apo ngritjes së vazhdueshme profesionale dhe kërkimin e të drejtave të saj ligjore në raport me kontratën, ligjin, pozicionin e punës. Siç konstatohet, kërkuesja është objekt jo vetëm i diskriminimit por njëkohësisht dhe i veprimeve të paligjshme e të padrejta, të njëanshme nga punëdhënësi i saj, duke cënuar kontratën

në mënyrë të njëanshme, ulje në detyrë, duke i mohuar të drejtën për ngritje në detyrë. Referuar tërësisë së provave të sipërcituara, konstatohet qartazi se marrëdhënia e punës fillestare ka qenë “Jurist” pranë ZABGJ, pastaj në mënyrë të njëanshme, jo ligjore, të padrejtë ka ndodhur ndryshimi i paligjshëm i pozicionit të saj të punës, nga “Jurist në Specialist.

- Jurist, “Specialist i Prokurimeve Publike”, “Person Përgjegjës për Dekriminalizimin” në KLGJ, jo në nivelin “Specialist”.

Përsa më lart, citohet se ndryshimi i organikës, strukturës, ka ndodhur në mënyrë të njëanshme ndaj kërkueses, duke cënuar intersat e saj ekonomike, pasurore, profesionale, të punësimit, por mbi të gjitha dhe duke cënuar dinjitetin, personalitetin e saj, i cili në mënyrë të njëanshme cënohej vazhdimisht nga punëdhënësi, duke mos i atribuar vlerat që i takonin në raport me kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës, vjetërsinë në punë, rezultatet e punës, ngritjen akademike gradualisht. Në këtë mënyrë nga ana e tyre është proceduar në përpjestim të zhdrejtë, pasi sa më shumë kualifikohej kërkuesja, aq më shumë ulej në detyrë dhe kishte ulje pozicioni pune nga profili fillestar.

Së dyti: *Diskriminimi i vazhdueshëm ndaj kërkueses nuk kishte të bënte vetëm me faktin e mosvlerësimit në pagesë sipas detyrës që ajo bënte, por mbi të gjitha të mohimit të drejtës për ngritje profesionale, duke e skualifikuar në mënyrë të padrejtë, të paligjshme kërkuesen nga konkurimi. Për të vërtetuar këtë pretendim kemi sjellë në cilësinë e provës shkresore, praktikën e aplikimit për pozicione të ndryshme pune të afishuara nga KLGJ, e konkretisht:*

Kërkuesja ka aplikuar apo ka shfaqur interes për ngritje në detyrë si “Shef i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve” fakt i vërtetuar me anë të kërkesës së datës 06.10.2023, pozicion në të cilin është skualifikuar me pretekstin se nga ana e kërkueses nuk është dorëzuar vlerësimi i fundit i punës.

Njëkohësisht nga ana e ankueses është proceduar dhe me aplikime për pozicionin e Këshilltarit në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershëm në Këshillin e Lartë Gjyqësor, datë 27.10.2022.

Arsyet e skualifikimit tek 2/1 (si më lart citohet) janë thjesht pretendime të pabazuara në ligj apo prova. Referuar kritereve të publikuara për aplikim në pozicionet e sipërcituara, nuk rezulton se nga ana e tyre të jetë kërkuar, në cilësinë e dokumentit paraqitja e vlerësimit të fundit të punës, por dhe sikur të ishte kriter, KLGJ është dashur të mos e marrë dosjen në dorëzim pa konstatuar mungesë dokumentacioni, apo të informonte kërkuesen për mungesën e dokumentacionit sipas kritereve të publikuara, duke theksuar dhe mos harruar mbi të gjitha faktin se kërkuesja ishte punonjëse pranë të njëjtit institucion, në të cilin kishte aplikuar për ngritje në detyrë, i cili ligjërisht ka dhe duhej të kishte tërësinë e dokumentacionit të kërkueses, përfshirë dhe vlerësimin e fundit të punës. Skualifikimi i kërkueses për mosplotësim dokumentacioni, është haptaz i padrejtë, i paligjshëm, i pabazuar në kriteret e publikuara nga ana e tyre, e mbi të gjitha diskriminues si rrjedhojë e çdo ankese, që ka bërë kërkuesja ndër vite, duke ngritur zërin për çdo shkelje, apo cënim të të drejtave të saj dhe mohim, apo mosdhënie të së drejtës për t'u ngritur në detyrë sipas ligjit.

Përsa më lart, çmojmë se ndaj kërkueses është ushtruar diskriminim për kushtet ku ndodhej, duke qenë subjekt i përjashtimit dhe kufizimit apo preferencës, që kishte si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Së treti: Trajtimi diskriminues i pësuar në vazhdimësi ndaj punonjësës ka konsistuar dhe me vlerësimin e pagës së saj, i cili ka pësuar ndryshime si rrjedhojë e pozicionit të gabuar të saj në klasa. Kështu, që në 2002-2013 rezultoi se ka qenë në cilësinë e “Juristit” pranë ZABGJ dhe pas vitit 2013 (2014 e në vazhdim) ka proceduar me ulje në detyrë, si më lart citohet dhe ulje page nga III-B në IV-I. Ky trajtim diskriminues, ka ndikuar jo vetëm në pagën e saj, apo profilizimin sipas viteve të punës, eksperiencës, rezultateve, por dhe të së drejtës së përfitimit për “Pagë shtesë si rrjedhojë e titullit Doktor Shkencash”. Sqarojmë se paga III-B nuk përfiton të drejtën e shtesës mbi pagë për gradat shkencore, e për rrjedhojë mosprofilizimi në vendin që i takon sipas ngritjeve akademike, ka sjellë pasojë negative dhe në përfitime të tjera monetare sipas ligjit.

Kjo është arsyeja që vazhdimisht nga ana e saj është kërkuar, që të procedohej me vlerësim dhe pozicionim në vendin që i takon (në raport me vitet e eksperiencës, detyrat që ajo bën dhe merr përsipër, ngritjen akademike), por kjo e drejtë i është mohuar vazhdimisht në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte.

Theksojmë se referuar Rregullores “Per Organizimin dhe Funksionimin e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor” neni 14- “Sektori i Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse”, pasqyrohen 2 pozicione të sektori drejtësisë — Shef Sektori, dhe Jurist/Specialist... por siç konstatohet nuk rezultojnë përshkrime pune, por puna që ka bërë kërkuesja përfshinte pozicionin “shef sektori” dhe jo thjesht specialist. Për të vërtetuar pretendimet e saj kemi sjellë në cilësinë e provës “Përshkrim pune”, të sipërcituar në rubrikën “Rrethana dhe Fakte”, ku pasqyrohet tërësia e punëve të realizuara nga kërkuesja, si dhe kopje të akteve të realizuara nga ana e saj, përfaqësime gjyqësore, autorizime, etj.. që vërtetojnë pretendimet e kërkueses.

Kjo është arsyeja se përse kërkuesja ka pretenduar vazhdimisht, se në pozicionet e punës ku ajo ka aplikuar, apo kanë qenë të lirë, janë marrë nga sistemi i jashtëm, pa i dhënë të drejtën apo mundësinë kërkueses për aplikim, duke theksuar faktin që “të përzgjedhurit” nuk kanë pasur as CV-në e kërkueses, as ngritjen akademike të saj, as profilizimin, e mbi të gjitha përkushtimin e saj për shumë vite në sistemin e drejtësisë, e pikërisht në këtë institucion.

Sqarojmë, se vazhdimisht nga ana e kërkueses janë bërë kërkesa ankimore sipas ligjit, pranë Bordit Drejtues të ZABGJ (2012-2014 e në vazhdim), përse i takon strukturës organike dhe përfshirjes së Juristit të ZABGJ në të, kategorizimit të drejtë të saj në pozicion dhe pagë, kërkesa të cilët nuk janë trajtuar në vendimet e ZABGJ “Për krijimin e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor” me vendim të Bordit Drejtues, apo ngritje profesionale. Nga ana e institucionit këto kërkesa nuk janë marrë në konsideratë dhe nuk është proceduar sipas ligjit.

Së katërti: Gjatë ankesave të vazhdueshme në rrugë administrative, ka parashtruar faktin se departamenti juridik, ka qëndruar jashtë strukturimit me ndryshimet e reja ligjore, duke theksuar faktin se fillimisht është emëruar "Jurist" institucioni, pastaj në mënyrë të padrejtë "Specialist strukture". Njëkohësisht dhe vazhdimisht veprimtaria juridike e institucionit është mbuluar gjatë gjithë kohës nga "Jurist i Zyrës", i cili ka trajtuar probleme të ndryshme ekonomiko-ligjore të Gjykatave, ndjekje të çdo procedure ligjore, hartim, administrim ligjor kontratash, përfaqësim ligjor, konsulencë ligjore për stafin, strukturat mbështetëse, dhënie mendimi për projekt ligje, prokurime publike, etj..

Të gjitha detyrat e sipërcituara kanë qenë të mbuluara nga një jurist pikërisht nga kërkuesja, duke e bërë të vështirë procedimin e punës, por mbi të gjitha paga III-B ka qenë diskriminuese, dhe jo në përputhje me detyra, të cilat përkonin me pozicionin "Shef sektori". Kjo është arsyeja që kërkuesja vazhdimisht ka kërkuar që në raport me klasën, profilin, punën, etj, të kategorizohej si nëpunës civil i mesëm drejtuese, kategoria II klasa b, pra II -B, fakt i cili nuk ndodhi asnjëherë për kërkuesen, as përsa i takon kategorizimit të duhur në raport me detyrat, as pagat, as ngritjen profesionale në detyrë. Për të vërtetuar këto pretendime, kemi sjellë aktet shkresore që disponojmë (duke theksuar se origjinali i kësaj ndodhet pranë ZABGJ sot KLGJ në arkivën e tyre, duke kërkuar vënien në dispozicion, të çdo akti të cituar në këtë ankese në formën e parashikuar nga ligji.

Çmujmë, se diskriminimi ka ardhur jo vetëm për faktin se është femër, e martuar me shtetas të huaj, por dhe si rrjedhojë e ankesave të bëra nga ana e saj, ku për këtë të fundit çmohet se përbën rrezik, që në të ardhmen t'i cenohet jo vetëm të drejtën për ngritje profesionale në të, por dhe të drejtën e punësimit, si rrjedhojë e largimit nga puna në mënyrë të padrejtë, për faktin e të "guxuarit" ligjërisht në kërkimin e së drejtës.

Së pesti: Kërkuesja ndihet e diskriminuar, pasi pavarësisht ngritjes akademike, profesionale, vjetërsisë në punë, rezultateve të mira në punë, korrektësisë, ndershmërisë, asaj nuk i jepet mundësia për ngritje profesionale siç më lart cituam, në raport me kualifikimet e saj, por përkundrazi, duke u cënuar dhe duke përzgjedhur persona të tjerë që nuk i kanë cilësitë, kriteret, kualifikimet e saj dhe kjo situatë ndërlikohet, vështirësohet vit pas viti, duke i rrezikuar të drejtën e saj për punësim, vlerësim, pagë dhe jetë të shëndetshme. Përmes veprimeve dhe mosveprimeve të realizuara nga KLGJ, kërkuesja nuk ndihet e barabaratë përpara ligjit apo barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në ngritje profesionale si të tjerët, duke kërkuar kështu mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin kundrejt personit të saj, i cili është prezent, i vazhdueshëm gjatë gjithë kohës.

Së gjashti: Çmujmë se kërkueses i është cënuar e drejta për punësim, si rrjedhojë e dallimeve, kufizimeve ose përjashtimeve në pjesëmarrje në konkurrim apo përzgjedhje, që ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve; c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet

profesionale. Nga ana e Punëdhënësit nuk është zbatuar apo mbrojtur, nxitur parimi barazisë dhe i ndalimit të çdo lloj diskriminimi; nuk janë marrë masat e nevojshme, përfshirë dhe masa disiplinore, për mbrojtjen e punëmarrësve nga diskriminimi dhe viktimizimi. Këto fakte vërtetohen në bazë të provave shkresore që i kam paraqitur për shqyrtim, por mbi të gjitha dhe të provave që ndodhen pranë KLGJ, ku në pozicionet që ka aplikuar janë emëruar persona që nuk kanë pasur profilizimin e saj në punë, vitet e eksperiencës, vjetërsinë aty, etj... duke e skualifikuar në mënyrë të padrejtë.

Së shtati: Referuar vlerësimeve në punë që ndodhen pranë (ZABGJ —KLGJ), rezulton se ndaj kërkueses nuk janë marrë ndonjëherë vërejtje disiplinore, apo të jenë filluar procedime disiplinore. Rezultatet në punë kanë qenë maksimale, ka përmbushur me sukses çdo detyrë të ngarkuar (madje duke kaluar pritshmëritë) pasi ishte Jurist i vetëm që mbulonte gjithë sektorin, duke bërë detyrat e 2-3 juristave njëherësh, apo të shefit të sektorit. Pavarësisht gjithë kësaj, kërkueses nuk ju dhanë shanset e barabarta, të njëjta me subjekte të tjerë për ngritje në detyrë, etj... Përtej procedurave dhe korrespondencave shkresore "Apliko sipas ligjit", kërkuesja është skualifikuar dhe diskriminuar, përjashtuar nga sistemi që në fazat e para, fakt i vërtetuar me anë të provave shkresore të paraqitura, bashkangjitur kësaj kërkesë. Kjo është arsyeja, se përse kërkuesja ka kërkuar konstatim dhe ndalimin e diskriminimit në punësim, pasi marrja në punë, kushtet e punës dhe shpërblimi duhet të jenë të njëjtë për të gjithë. Asnjë punëdhënës/e, nuk mund të përjashtojë pa arsye dikë nga mundësia për të punuar, për t'u ngritur në detyrë, duke pretenduar se kërkuesja është penguar vazhdimisht për ngritje në detyrë. Përsa më lart citohet, çojmë se kërkuesja është përjashtuar, kufizuar, në ushtrimin e të drejtave të saj, sipas neni 1 të Ligjit Nr. 10221/2010, sepse është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të ngjashme.

Së teti: Përsa më lart citohet, çojmë se kërkuesja është objekt diskriminimi i të gjitha formave të saj e konkretisht: "Diskriminim i drejtpërdrejtë" është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

"Diskriminim ndërsektorial" është ajo formë diskriminimi, në të cilën disa shkaqe veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëra-tjetrën në të njëjtën kohë, në mënyrë të tillë që ato të jenë të pandashme dhe të prodhojnë forma të veçanta, të diskriminimit.

"Diskriminim i shumëfishtë" është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në dy ose më shumë shkaqe që veprojnë veçmas.

"Diskriminim strukturor" është ajo formë diskriminimi që u referohet rregullave, normave, praktikave, modeleve të qëndrimeve dhe sjelljeve në institucione dhe në struktura të tjera shoqërore, që në mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme paraqesin pengesa për grupet ose

individët, për të pasur të njëjta të drejta dhe mundësi si të tjerët dhe që kontribuojnë në rezultate më pak të favorshme për ta, në raport me të tjerët.

"Diskriminim i tërthortë" është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen, që e ka shkaktuar atë.

Çmujmë se gjatë gjithë kohës, ka ekzistuar kjo sjellje diskriminuese ndaj kërkueses, që është motivuar nga më shumë se një shkak, kur është kryer më shumë se një herë, kur ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore, ose kur ka sjellë pasojë veçanërisht të dëmshme për viktimën përbën formë të rëndë, të diskriminimit.

Sa më sipër, kërkohet nga Komisioneri : 1- Pranimin e kërkesës. 2- Konstatimin e diskriminimit për arsye gjinore, gjendje familjare, martesore, ose për çdo shkak tjetër, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ndaj ankueses znj.R. I.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma "a", të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke garantuar mbrojtje të drejtpërdrejtë nga diskriminimi për shkak të moshës, duke përcaktuar në nenin 1, të tij se: "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër."

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi, të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Në Kreun II, të LMD parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Konkretisht, neni 12/1/c, i LMD, ku parashikohet se : *"Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje*

me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”, ndalon diskriminimin që mund t’i bëhet punëmarrësit jo vetëm në lidhje me momentin e pushimit nga puna apo zgjidhjes së kontratës së punës, por edhe trajtimin diskriminues gjatë marrëdhënies së punës në të gjitha elementët e kësaj marrëdhënie.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1- Me shkresën me nr.1368/1 prot., datë 26.12.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, duke kërkuar informacionin si më posht vijon:

- Informacion në lidhje me pretendimet e ankueses për sa parashtrohet në ankesën e saj.
- Detyrat funksionale të saj sipas rregullores së punës së institucionit.
- Kopje të urdhrëve me anë të cilave është ngarkuar të kryej funksione të tjera dhe interpretimin e tyre në lidhje me funksionin që është emëruar. (njoftime, procesverbale, ankimet dhe kthim përgjigjet si dhe çdo akt ose korrespondencë të mbajtur për këtë qëllim)
- Informacion për masat e marra nga ana e institucionit, për rregullimin e situatës mbi ankesën lidhur me ndryshimin e kategorisë së saj, nga III B në IV-I.
- Informacion lidhur me kërkesën e ankueses për emërimin e saj si këshilltar, si janë trajtuar ato, si dhe kopje të përgjigjeve që i janë kthyer ankueses. (shkaqet, kriteret e mospranimit)
- Informacion lidhur me shkaqet ligjore që kanë shërbyer për skualifikimin e saj në lidhje me procedurën e konkurimit, për pozicionin e shpallur të lirë “Shef i Sektorit të Burimeve Njerëzore”. Pse nuk u pranua ankimi në lidhje me vlerësimin e punës, në kushtet kur vlerësimi ishte akt i administruar nga e njëjta njësi përgjegjëse?
- Kopje të akteve të brendshme normative të Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbi bazën e të cilave janë rregulluar marrëdhëniet e punës së ankueses dhe mbi bazën e të cilave është sistemuar ankuesja në pozicionin aktual.
- Çdo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm se do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

1.1 Me shkresën nr.6611/1 prot., datë 04.01.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi në dispozicion të Komisionerit dokumentacionin që dispononte ky organ, duke dhënë dhënë

shpjegime në lidhje me pretendimet e ngritura nga znj. R. I, në ankesën e saj, duke sqaruar se:

Znj. R. I, me vendimin nr.38, datë 24.06.2019 është transferuar në mënyrë të përhershme për shkak të ristrukturimit, nga pozicioni i specialistes jurist, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, pranë ish- ZABGJ-së, (nëpunës civil, kategoria ekzekutive), kategoria e pagës III-b, në pozicionin specialist, në Sektorin e Administrimit të Prokurimeve, në Drejtorinë e Shërbimeve Administrative, në Departamentin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, (nëpunës civil, kategoria ekzekutive) kategoria e pagës III-b.

Në zbatim të VKM-së nr.125, datë 17.02.2016 "Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civil", kreu II, pika 16, "Në rastet e mbylljes apo ristrukturimit, njësi përgjegjëse krijin komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë të së njëjtës kategori apo përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësit". (bashkëlidhur procesverbali nr.3107 prot., datë 19.06.2019, vendimi nr.21, datë 21.06.2019, vendimi nr.38, datë 24.06.2019, si dhe shkresa nr.3195/3 prot., datë 25.06.2019, gjithsej 8 fletë)

Referuar Rregullores së Brendshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor miratuar me Urdhër nr.12, datë 14.01.2021 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor", si dhe formularit të përshkrimit të punës, përcjellim detyrat funksionale të pozicionit specialist, në Sektorin e Administrimit të Prokurimeve, në Drejtorinë e Shërbimeve Administrative, në Departamentin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë vijon:

"Përgatit regjistrin e parashikimit të prokurimeve, konform buxhetit të miratuar për investime dhe për shpenzime;

Harton dokumentacionin përkatës për procedurat e prokurimit dhe shpalljen e tyre në APP;

Përditëson të dhënat në sistemin elektronik për procedurat e prokurimit dhe përgatitjen e procedurës, për në KVO-në;

Administrimin elektronik, në mënyrë periodike të procesit të prokurimit, nga shpallja e procedurës deri në arshivimin e saj;

Hedh on-line të gjithë materialin e procedurës së prokurimit;

Mban marrëdhënie periodike, ditore-javore me Agjencinë e Prokurimit Publik;

Njofton në mënyrë elektronike dhe shkresore, Agjencinë e Prokurimit Publik për fazën e publikimit, njoftimin e fituesit, lidhjes së kontratës dhe anulimeve përkatëse, sipas afateve të përcaktuara në ligj për secilën procedurë;

Harton kontratat dhe njofton subjektin për nënshkrimin e saj;

Harton dhe manaxhon Regjistrin e Procesit të Prokurimit i cili mbahet në protokollin e institucionit;

Asiston në mbledhjet e KVO-së dhe jep mendim si dhe bën interpretim ligjor për dokumentat e tenderit, atëherë kur i kërkohet nga anëtarët e KVO-së;

Shqyrton, trajton dhe kthen përgjigje, të gjitha ankesave që kanë të bëjnë me dokumentat e tenderit; përpara hapjes së procedurës dhe vë në dispozicion të gjithë materialin e nevojshëm për trajtimin e ankesave;

Zbaton detyrat e ngarkuara sipas rregullores në fuqi dhe përshkrimit të vendit të punës si dhe planeve të punës të miratuara nga eprori përkatës;

Informon eprorin direkt mbi rezultatet e punëve në vazhdimësi dhe mbi vështirësitë e hasura në lidhje me to;

Punon për rritjen dhe kualifikimin e tij profesional në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, duke synuar sjelljen e risive në punën e tyre të përditshme;

Zbaton të gjitha detyrat e tjera të paplanifikuara dhe që mund të ngarkohen nga eprori, apo detyrat e dala nga bashkëpunimi ndërsektorial që nuk përfshihen në pikat më lart, që nuk përbëjnë shkelje ligjore, dhe që nuk çenojnë dinjitetin e punonjësit".

- Gjithashtu, referuar vendimit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015"Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", i ndryshuar, kreu II, pika 5. "Secili prej organeve përgjegjëse për administrimin e formularit të vetëdeklarimit krijon një strukturë të posaçme ose cakton personat përgjegjës për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularit", sqarojmë se me Urdhër nr.18, datë 26.03.2021 "Për një ndryshim në urdhrin nr.93, datë 27.10.2020 "Për përcaktimin e personave përgjegjës nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, për strukturën e posaçme për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr.138/2015"Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" i ndryshuar, në Këshillin e Lartë Gjyqësor", janë përcaktuar 2 (dy) personat përgjegjës për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularit të vetëdeklarimit, një prej të cilave është dhe znj. R.I. Në zbatim të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, pavarësisht detyrave të cilat i ngarkohen nëpunësit civil në mënyrë verbale dhe /ose me urdhër, ai trajtohet financiarisht, sipas pozicionit të punës që mban, apo është emëruar/transferuar në mënyrë të përhershme. (bashkëlidhur urdhri nr.18.datë 26.03.2021, gjithësej 2 fletë)

- Në zbatim të ligjit 34/2023 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9484, datë 17.07.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavaruara, të krijuara me ligj" i ndryshuar, si dhe VKM-së nr.325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturave të pagave, niveleve të pagave dhe shtesa të tjera mbi pagë të Zëvendministrit, funksionarëve të kabineteve, Prefektit, Nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve të Administratës publike", lidhja7/2/b, specifikohet se pozicioni specialist (kategoria ekzekutive) III-b është i barazvlefshëm me klasën e pagës IV-I.

Me vendimin nr.433, datë 24.07.2023 "Për një ndryshim në vendimin nr.157, datë 20.04.2022 "Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë

Gjyqësor", Këshili i Lartë Gjyqësor ka miratuar strukturën duke pasqyruar klasën e pagave të reja, sipas VKM-së së sipërcituar.

Sa më sipër, në zbatim të ndryshimeve ligjore, nuk kemi ulje kategorie page, por thjesht ndryshim emërtese. Pra, sqarojmë se Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka zbatuar ndryshimet ligjore, për sa përcaqton VKM-ja, në këto kushte të gjithë nëpunësit civil, pjesë e strukturës organizative, në kategorinë ekzekutive, trajtohen me të njëjtën klasë page. (bashkëlidhur, shkresa nr.5382/1 prot., datë 31.10.2023, si dhe shkresa nr.5382 prot., datë 17.10.2023, gjithësej 55 fletë)

- Referuar pozicionit të shpallur vakant Këshilltar në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, datë 25.10.2022 në zbatim të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neni 26, pika 1, "Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët ose të mesme drejtuese bëhet, së pari, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe, në rast të mosplotësimit të vendit të lirë, me procedurën e ngritjes në detyrë", sqarojmë se procedura është mbyllur me shpalljen e fituesit, sipas procedurës së lëvizjes paralele.

Bazuar në parimet e shërbimit civil, si dhe kritereve të konkurimit në procedurat për pozicionet e nivelit të mesëm drejtues, specifikohet ndër të tjera në ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neni 26, pika 3, se mund të aplikojnë nëpunësit civil të një kategorie paraardhëse, nëpërmjet ngritjes në detyrë.

Për sa i përket, sistemimit të pozicionit të Këshilltar, ju informojmë se pozicioni Këshilltar në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, klasa e pagës II-1, klasifikohen në kategorinë e mesme drejtuese.

Pra mund të aplikojnë për ngritje në detyrë nëpunësit e kategorisë së ulët drejtuese, znj. R.I në momentin e aplikimit dhe aktualisht mban pozicionin specialist, në Sektorin e Administrimit të Prokurimeve, pozicion i kategorisë ekzekutive.

- Me shkresën nr.3992 prot., datë 13.07.2022, znj.R. I, ka kërkuar shtesë në pagë për fitimin e gradës shkencore "Doktor".

Me shkresën nr.3992/1 prot., datë 27.07.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i është kthyer përgjigje duke ju cituar: VKM-ja nr.187, datë 08.03.2017 "Për miratimin strukturës dhe niveleve të pagave të nëpunësve civil/nëpunësve, zëvendministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavaruara, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrive të linjës dhe administratës së prefektit", i ndryshuar, shtesa për kualifikim në shërbim civil aplikohet për kategoritë e pagave nga kategoria II-b ose më lart, si dhe miratohet në institucionet e pavaruara nga njësia e manaxhimit të burimeve njerëzore, kur kualifikimi, grada apo titulli shkencor, përputhen me përshkrimin e punës". (bashkëlidhur, shkresa nr.3992/1 prot., datë 27.07.2022 si dhe shkresa nr.3992, datë 13.07.2022 gjithësej 4 fletë).

- Në aplikimin e znj. R.I, për ngritjen në detyrë në pozicionin e shpallur vakant, Shef Sektori, në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve për Administratën, në Drejtorinë

e Burimeve Njerëzore, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, ju bëjmë me dije se referuar VKM-së nr.242, datë 18.03.2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar, Kreu III, pika 2 c, "Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për procedurë janë: c)- të ketë të paktën vlerësimin e fundit "Mirë" apo "Shumë mirë", specifikohet si më sipër cituar se një ndër kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati, është ndër të tjera është dorëzimi i vlerësimit të fundit, ku me "të fundit", aktet nënligjore në fuqi nënkuptojnë vlerësimin e fundit, 6 mujor për periudhën kur konkuron, pra në rastin konkret vlerësimi i fundit i 6 mujor, përkon me periudhën janar-qershor 2023. Ndërsa nga znj. R. I, është depozituar vlerësimi për periudhën korrik-dhjetor 2022.

Gjithashtu, në shpalljen e pozicionit vakant të publikuar në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor citohet: Mosparaqitja e plotë e dokumentave të sipërcituara, sjell skualifikim të kandidatit". Sqarojmë se, trajtimi i kandidatëve në procedurat e rekrutimit bëhet në mënyrë të barabartë, pa diskriminuar apo favorizuar askënd, pjesë e stafit të institucionit, i cili ka shpallur vendin vakant, ose jo.

Mungesa e dokumentacionit përkatës sjell skualifikimin e kandidatit.

Pavarësisht, afati i ankimit për plotësimin e dokumentacionit, në mënyrë që të vijonte konkurimin, znj. I, ka shprehur vullnetin e saj të lirë, tërheqjen nga konkurimi.

(bashkëlidhur shkresa nr.5674/1 prot., datë 02.11.2023, shkresa nr.5674 prot., datë 30.10.2023, si dhe komunikimi elektronik, gjithsej 11 fletë)

Për sa më sipër, ju bëjmë me dije se, në zbatim të ligjit 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar, nuk vihet re asnjë formë diskriminimi, përveçse janë zbatuar aktet ligjore/nënligjore në fuqi, për të gjitha kërkesat dhe pretendimet e znj. R.I: akte të cilat zbatohen njësoj për të gjithë nëpunësit e institucionit, si dhe për kandidatët të cilët aplikojnë në procedura rekrutimi. (Bashkëlidhur, ju dërgojmë aktet në lidhje me pretendimet e ngritura nga znj. R. I, gjithësej 80 (tetëdhjetë) fletë.

2. Në datën 17.01.2024, ankueses iu komunikuan nëpërmjet postës elektronike (me e-mail) përgjigja e sipërcituara.

Në datën 24.01.2024 ankuesja depozitoi kundërshtimet e saj administruar pranë Komisionerit me nr.21/2 prot., datë 24.01.2024, ku ka parashtruar se:

Në kuadër të ushtrimit, të së drejtës së mbrojtjes dhe paraqitjes se parashtrimeve, pasi u njohëm me shkresën "Kthim përgjigje", nr. 6611/1 prot., datë 04.01.2024 dhe provave bashkëngjitur, nuk jemi dakort me pretendimet e tyre, për arsye që po citojmë, si më posht vijon:

Së pari: Konstatohet qartazi dhe përmes pohimeve të realizuara nga vetë Këshilli i lartë Gjyqësor Tiranë, që nga ana e tyre është proceduar me ndryshim kontrate të punës në mënyrë të njëanshme, pa paralajmërim, duke proceduar me ulje në detyrë, e cila është bashkëshoqëruar njëkohësisht dhe me ulje page, dy elementë thelbësorë në këto të një marrëdhënie pune, marrëdhënie kontraktore

apo statusit të nëpunësit civil. Siç është cituar dhe nga ana e tyre, në zbatim të VKM nr.125, datë 17.02.2016 "Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civil", në rastet e mbylljes apo ristrukturimit, njësia përgjegjëse krijin komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese. Nga ana e tyre, përmes kësaj shkrese dhe provave bashkëngjitur, nuk na është bërë e qartë apo nuk na është vënë në dispozicion:

1. Struktura para vitit 2019 (para ndryshimeve legislative dhe në strukturë), duke pozicionuar dhe ankuesen në këtë strukturë.
2. Struktura pas vitit 2019 (pas emërimit me vendimin nr.38, datë 24.06.2019), duke pozicionuar dhe ankuesen në këtë strukturë.
3. Nëse në strukturën e re (2019) ka pasur vende të lira në pozicionin e juristes, shefes së Departamentit dhe nëse ka pasur, arsyeja se përse nuk është emëruar ankuesja.
4. Informacion lidhur me personat që janë emëruar jurist, shefa sektori në strukturën e re, duke e shoqëruar me informacionin lidhur me CV e tyre dhe vitet e vjetërsisë në punë, për secilin nga të emëruarit në strukturën e re.

Për sa më lart citohet, konstatohet qartazi, se emërimi i saj si "Specialiste e Administrimit të Prokurimeve", në Sektorin e Administrimit të Prokurimeve, Drejtorinë e Shërbimeve Administrative, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, është bërë në mënyrë të padrejtë, pasi nga juriste institucioni, është transferuar në specialist prokurimesh brenda Departamentit të Burimeve Njerëzore. Nga ana e KLGJ-së nuk na është sjellë informacion lidhur me ndonjë strukturë të re, për ekzistencën e ndonjë Departamenti Juridik, struktura e brendshme e tij, dhe kriteret lidhur me të punësuarit në këtë Departament. Por mbi të gjitha, cila është arsyeja që ankuesja nuk është transferuar në një Departament Juridik, ku kishte një CV të pasur dhe një eksperiencë të mirëfilltë si juriste?!...

Duke qenë në këto kushte, pretendimet e KLGJ-së lidhur me transferimin e ligjshëm të saj janë të pabazuara në ligj, aktet nënligjore dhe as rregullore.

Së dyti: Nga ana e KLGJ-së, nuk është pasqyruar saktë pozicioni "de jure" dhe "de facto" i ankueses. Nga ana e tyre, na janë vënë në dispozicion detyrat funksionale të pozicionit "Specialiste e Administrimit të Prokurimeve", në Sektorin e Administrimit të Prokurimeve, Drejtorinë e Shërbimeve Administrative, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor", por të dhënat që na kanë vënë në dispozicion nuk përkohjnë totalisht me realitetin. Nga ana e kërkueses është vënë në dispozicion praktikë shkresore (e pjesëshme), pasi pjesa tjetër ndodhet në institucion ku pasqyrohet qartazi, që detyrat e realizuara nga ana e ankueses kanë qenë përtej asaj të cituar në shkresën (kthim përgjigje). Pasi (de facto) ankuesja ka përmbushur detyrat e juristes së Institucionit, duke proceduar dhe me dhënien mendim juridik për çështjet ligjore ndër vite (dhe jo vetëm sektorit të prokurimeve) përfaqësime në gjyqe, etj.... Ndërkohë, që vlen për tu theksuar se emërimi i saj në pozicionin adekuat në raport me anën e saj akademike dhe vitet e punës, nuk ndodhi kurrë, pavarësisht se çdo vit, nga ana e ankueses u dëshmuua për rritje akademike, profesionale, pasi nuk ju mundësua asnjëherë dhe rritja në pozicion (vende të lira punë të hapura nga KLGJ)

Së treti: Referuar emërimin në strukturën e posaçme për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularit të vetdeklarimit, është sërish tendencioze në kundërshtim me ligjin, pasi kemi sërish ndryshim të njëanshëm të kontratës së punës, pasi ankueses i shtohen detyrat, përgjegjësitë, duke mos ju rritur rroga shtesë, por mbi të gjitha, qartazi konstatohet se pozicioni i regjistrueses së formularëve, nuk ka të bëjë fare me profilin e punës që ka patur ankuesja, diplomat e saj, por edhe vitet e eksperiencës në punë si juriste. Duke qenë në këto kushte, vazhdon sërish ndryshimi i pozicionit të saj të punës, ulja e pagës dhe diskriminimi në raport me juristët e tjerë të punësuar pranë KLGJ, veçanërisht në Departamentin Juridik, në mënyrë të njëanshme dhe të padrejtë. Jemi të sigurtë se mosprofilizimi në Departamentin e duhur, në raport me CV dhe vitet e punës, ka sjellë si pasojë që ankueses t'i ngarkohen detyra jo në raport me profilin e saj, siç mund të jetë dhe "Protokolli", i cili është emërtuar dhe si njësi regjistrimi, administrimi formularësh....

- 1. Kërkojmë që nga ana e KLGJ-së të na jepet një informacion, kjo detyrë a i është ngarkuar juristëve, shëfave të sektorit të Departamentit Juridik, dhe nëse jo, cila është arsyeja ???!*
- 2. A përkon profili i punës si specialist prokurimesh me detyrën protokollim dhe regjistrim formularësh vetëdeklarimi?*
- 3. Cilët janë kriteret për këtë pozicion pune cili është klasa që korrespondon me këtë profil pune, duke e bashkëshoqëruar me klasën përkatëse dhe pagën respektive?*

Së katërti: Referuar aplikimit të bërë nga ana ime, për pozicione vakante si shefe e burimeve njerëzore, nga ana e KLGJ jam skualifikuar në mënyrë të padrejtë. Justifikimi se nga ana ime nuk është paraqitur vlerësimi i fundit i punës është tendencioz dhe diskriminues, për arsyet që po citojmë si më poshtë:

- 1. Sjellim në vëmendje, se vlerësimi i fundit i punës nuk është i njëjtë për të dyja palët në këtë proces. Vlerësimi i fundit i punës për mua, është ai që më është vënë në dispozicion, pra ai i paraqitur sipas ligjit. Është normale që nëse unë do të kisha vlerësimin e 6-mujorit të parë të 2013 do ta kisha paraqitur, ndodhur në këto kushte, vlerësimi i fundit i punës për mua është ai i 6-mujorit të dytë të vitit 2022.*
- 2. Vlerësimi i fundit i punës për KLGJ është 2023 (me të drejtë) por është një akt që e disponojnë burimet njerëzore të institucionit dhe mua nuk më është vënë asnjëherë në dispozicion.*
- 3. Në rastin konkret, veprimi i KLGJ-së ka qenë dashakeqës dhe diskriminues kundrejt meje, pasi nuk më ka vënë në dispozicion vlerësimin e punës, që ligjërisht duhej të ma kishte vendosur në dispozicion, në mënyrë që të më mundësohej paraqitja e tij edhe në vende të tjera pune, apo aplikime të tjera.*
- 4. Përmes vërtetimeve të punës që kam sjellur, rezulton që ndaj meje nuk ka pasur vëretje disiplinore, procedim disiplinor.*
- 5. Referuar vlerësimin të punës që unë kam depozituar 2022 por dhe nga vlerësimet e mëparshme rezulton se unë jam vlerësuar për rezultate në punë, me nivelin maksimal "shumë mirë".*
- 6. Vlerësuar praktikës time ndër vite (pasi unë nuk jam person që vij nga jashtë) sepse kam punuar pranë këtij institucioni prej vitesh, të gjithë e dinë korrektesën, saktësinë e punës së kryer nga ana ime.*

Për sa më lart citohet, kostatohen qartazi qëndrimet e ndryshme, e mbi të gjitha diskriminuese të bëra ndaj personit tim, jo vetëm për faktin që nuk më kanë vënë në dispozicion vlerësim pune (e detyrueshme për konkurim), por njëkohësisht dhe skualifikimi i bërë për diçka që unë se posedoj, e mbi të gjitha për diçka që ato e posedojnë dhe më kanë mohuar të drejtën ta posedoj. Jam e sigurtë që nëse do ta kisha, do të gjendej një mënyrë tjetër për të më skualifikuar, apo mohuar të drejtën për konkurim dhe ngritje në detyrë.

Së pesti: Jam kundër dorëheqjes së cituar nga ana e tyre. Nuk është dorëheqje me vullnet të lirshëm, por është kushtëzuar si rrjedhojë e mbylljes së çdo rruge, mundësie nga ana e KLGJ-së kundrejt personit tim. Qartazi në korrespondencën time kam kontestuar, duke thënë se ky skualifikim është i padrejtë, i paligjshëm dhe i pajustificuar, duke e justifikuar ligjërisht qëndrimin tim. Në momentin që kam konstatuar se e gjitha kjo kishte karakter diskriminues kundrejt meje, duke më mohuar dhe të drejtën e pjesmarrjes në konkurim, duke qenë koshiente për CV time, vitet eksperiencës, jam shprehur se: - "përballë një qëndrimi të tillë është e kotë të vazhdoj më tutje interesimin për këtë konkurim, tërhiqem nga ky konkurim dhe njëkohësisht kërkoj kthimin mbrapsht të dokumentave të paraqitura".

1. Kjo "pseudo tërheqje" ka ndodhur pas skualifikimit të padrejtë dhe jo gjatë procedurës së konkurimit, fakt lehtësisht i verifikueshëm;

2. Skualifikimi ka qenë tendencioz dhe i menjëhershëm, duke më mohuar të drejtën më esenciale atë të konkurimit,

Duke qenë se u keqtrajtova në këtë mënyrë nga institucioni ku unë punoj, ishte dhe është e kotë të vazhdoja të kisha shpresa për "dhënie drejtësie" nga KLGJ, e cila qëllimisht ka vepruar në këtë mënyrë. Ndaj tërheqja ime është e kushtëzuar, e detyruar, pasi ato më penguan dhe më mohuan të drejtën të konkuroj sipas ligjit, duke më mohuar të drejtën për tu pajisur me dokumentin që ato vetë e posedonin dhe mospasja e dokumentit ishte kriter skualifikues në konkurim.

Së gjashti: Nga ana e KLGJ-së, vazhdon sërish diskriminimi kundrejt meje, pasi siç vërtetohet përmes provave shkresore të paraqitura nga ana e tyre nuk jam informuar lidhur me aplikimin tjetër të bërë nga ana ime "Këshilltar" në Njësin Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme në Këshillin e Lartë Gjyqësor datë 27.10.2022. Në prapësimet e KLGJ-së nuk është thënë asgjë në lidhje me këtë aplikim, nëse isha kualifikues, skualifikues dhe kush ishte fituesi, apo rezultati i fitimit përkatës.

Ndodhur në këto kushte, me të drejtë mendoj se jemi përpara emërimeve të njëanshme dhe konkurimet janë de facto sa për të plotësuar ligjërisht një procedurë formale, ku paraprakisht dihet se kush do të vendoset në çdo vend pune, që shpallet për konkurim. Është e pamundur, e paimagjinueshme që me CV që posedoj, vitet e punës, eksperiencën time, të mos kem vendin e punës që më takon, përse i marrin nga jashtë institucionit, ku këto të fundit nuk kanë CV time dhe as eksperiencën e punës që unë disponoj. Ky veprim është jo vetëm diskriminues kundrejt personit tim, por dhe i paligjshëm, i padrejtë, pasi pengon në rritjen time të mëtejshme profesionale, sic e parashikon dhe ligji.

Së shtati: Nga ana ime është kërkuar pagesë dinjitoze në raport me një emërim dinjitoz. Mosemërimi në vendin që më takonte dhe më takon sipas të dhënave në dosjen personale të punës, më ka mohuar disa të drejta që ligjërisht do më takonin, si më posht citohet:

- 1. Klasifikimi në klasën e duhur sipas ligjit dhe jo atë të nivelit më të ulët;*
- 2. Pagesë adeguate sipas kategorisë dhe klasës përkatëse;*
- 3. Pagesë e gradës "Doktor", në përputhje me klasën e duhur (që ligjërisht më takonte, nëse do të ishte kryer klasifikimi i duhur i drejtë, i pagës për detyrën e mbajtur në institucion nga ku jam transferuar dhe institucionin ku ndodhem aktualisht KLGJ);*
- 4. Të drejtën për rritjen graduale, profesionale të mëtejshme.*

A kemi diskriminim? Mjafton të shikosh emërimet ndër vite në pozicione ku unë kam aplikuar, si jam skualifikuar me pa të drejtë më takonte, pavarësisht se personat e emëruar nuk kishin as gjysmën e CV time apo të kualifikimeve, eksperiencën dhe vjetërsinë time në punë. Pra çmoj, se kemi diskriminim të vazhdueshëm, të pandërprerë dhe të qëllimshëm, duke më mohuar çdo mundësi për rritje profesionale, lëvizje paralele apo ngritje në detyrë. Përmes diskriminimit të realizuar kundrejt personit tim, jo vetëm që më është mohuar e drejta për punësim të parashikuar nga ligji, duke më mohuar emërtesën e profesionit që kam patur dhe ushtruar me vite, e për këtë shkak edhe të drejtën për pagë dinjitoze në raport me të gjitha apo që citova më lart.

Përfundimisht, pretendimet e KLGJ-së të paraqitura në shkresë janë thjeshtë formale, të mangëta të paplota, të paligjshme, të padrejta dhe të pabazuara në prova. Nga ana e tyre nuk është pasqyruar realiteti përsa i takon strukturave, emërimeve, pozicioneve, duke më bërë të ndihem gjithmon e diskriminuar në vendin tim të punës. Kërkoj që të mos merren në konsideratë, duke kërkuar pranimin e kërkesës ankimore.

II. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës rezultoi e provuar se, ankuesja R. I, e datëlindjes 01.09.1975, është banuese në qytetin e Tiranës dhe pretendon se është diskriminuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë nga institucioni i Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të *gjinisë, gjendjes familjare, martesore dhe çdo shkak tjetër.*

Aktualisht është e punësuar si specialiste e Administrimit të Prokurimeve, në Sektorin e Administrimit të Prokurimeve, Drejtorinë e Shërbimeve Administrative, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pozicion në të cilin është emëruar në bazë të Vendimit nr.38, datë 24.06.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me anë të cilit është transferuar në mënyrë të përhershme për shkak të ristrukturimit, si nëpunës civil, kategoria ekzekutive me kategori page III-b.

Pozicioni i mëparshëm i mbajtur nga ankuesja, referuar vendimit të sipërcituar rezulton të ketë qenë ai i specialistes/jurist, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, pranë ish- ZABGJ-së, (nëpunës civil, kategoria ekzekutive), kategoria e pagës III-b. Nga aktet e administruara rezulton se marrëdhëniet e punës me institucionin e ZABGJ-së ankuesja i ka filluar që në vitin 2004, si juriste, referuar Urdhrit të emërimit nr.22 prot., datë 08.03.2004 dhe kontratës së punës të datës 09.06.2004 lidhur mes Punëdhënësit ZABGJ dhe saj.

Referuar Akt Deklarimit të Statusit të Punësimit nr.37 prot., datë 03.06.2014 të ZABGJ-së znj. R. I, deklarohet "Nëpunës Civil", në pozicionin "Specialist/Jurist", në Sektorin e Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse të Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, me kategorizim page III-b.

Në bazë të Vendimit nr.12, datë 18.01.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor", i ndryshuar është bërë ristrukturimi i institucioneve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të ish- Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor.

Në kuadër të këtij ristrukturimi në bazë të Urdhrit nr.39, datë 10.06.2019 është urdhëruar: *Krijimi i Komisionit të strukturimit, në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për kryerjen e procedurës së transferimit, për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit.*

Me shkresën nr.3195 prot., datë 12.06.2019 me lëndë: *Njoftim për fillimin e procedurës së transferimit,* znj. R. I, në cilësinë e Specialist/ Juristes në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse, është njoftuar lidhur me fillimin e këtij procesi.

Në bazë të shkresës nr.3195/2 prot., datë 24.06.2019, dhe Vendimit nr.38, datë 24.06.2019, është vendosur transferimi i përhershëm i znj. R. I, në pozicionin e Specialistes së Administrimit të Prokurimeve në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Njoftim i cili i është bërë ankueses në bazë të shkresës nr.3195/3 prot., datë 25.06.2019.

Trasferimi i mësipërm rezulton të jetë kundërshtuar nga ana e ankueses në bazë të kërkesës të datës 28.06.2019, me objekt: *Kërkesë për rishikimin e Vendimit nr.38, datë 24.06.2019 "Mbi transferimin e përhershëm të znj. R.I në pozicionin e Specialistes në Administrimin e prokurimeve në Këshillin e Lartë Gjyqësor".*

Me shkresën nr. 3195/5 prot., datë 01.07.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka kthyer përgjigje ankueses dhe ndër të tjera ka sqaruar se transferimi është bërë në të njëjtën kategori si nëpunës civil që keni patur në pozicionin e mëparshëm të ish- ZABGJ-ja, nivel ekzekutiv si dhe me të njëjtin nivel page.

Me Urdhrin nr.18, datë 26.03.2021 "Për një ndryshim në urdhërin nr.93, datë 27.10.2020 "Për përcaktimin e personave përgjegjës nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, për strukturën e posaçme për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" i ndryshuar, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor", janë përcaktuar 2 (dy) personat përgjegjës për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularit të vetëdeklarimit, një prej të cilave është dhe znj. R. I.

Me kërkesën e administruar në Këshillin e Lartë Gjyqësor me nr.akti 5267 prot., datë 15.11.2021, ankuesja ka kërkuar nga Institucioni që të trajtohet si anëtare zëvendësuese për Komisioner në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, e zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë, duke kërkuar përfshirjen e një zyre, një post parkimi në vendparkimin e automjeteve të institucionit, me mjetet e tjera të përshtatshme të punës, si dhe me shpenzimet e transportit sipas limitit të karburantit që aplikohet, referuar nenit 29 të ligjit nr.84/2016. Kërkesë e cila është gjykuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si një kërkesë e pabazuar ligjërisht.

Me kërkesën e administruar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr.3992 prot., datë 13.07.2022, nga ankuesja është kërkuar shtesë page për fitimin e gradës shkencore "Doktor", sistemimin e saj në pozicionin Këshilltar ligjor.

Nga institucioni është kthyer përgjigje me shkresën nr. 3992/1 prot., datë 27.07.2022 ku ka bërë më dije ankuesen se shtesa për kualifikim në shërbimin civil, aplikohen për kategoritë e pagave nga kategoria II-b ose më lart, si dhe miratohet për institucionet e pavaruara nga njësia e manaxhimit të burimeve njerëzore kur kualifikimi, grada apo titulli shkencor, përputhen me përshkrimin e punës. Ndërsa në lidhje me kërkesën për pozicionimin e saj si Këshilltar ligjor, ky pozicion është pjesë e pozicioneve të punës të shërbimit civil dhe si i tillë si fillim duhet të shpallet i lirë dhe më pas të aplikohet për procedurën konkurrese sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Me kërkesën e datës 27.10.2022, nga ana e ankueses është proceduar dhe me aplikimin për pozicionin e Këshilltarit në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershëm në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Referuar përgjigjes të kthyer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në lidhje me këtë kërkesë së ankueses, është shprehur se në zbatim të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neni 26, pika 1, "Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët ose të mesme drejtuese bëhet, së pari, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe, në rast të mosplotësimit të vendit të lirë, me procedurën e ngritjes në detyrë". Për sa i përket, sistemimit të pozicionit të Këshilltar, pozicioni Këshilltar në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, klasa e pagës II-1, klasifikohen në kategorinë e mesme drejtuese, pra mund të aplikojnë për ngritje në detyrë nëpunësit e kategorisë së ulët drejtuese, ndërsa Znj. I, në momentin e aplikimit dhe aktualisht mban pozicionin specialist, në Sektorin e Administrimit të Prokurimeve, pozicion i kategorisë

ekzekutive. Ndërhohë kjo procedurë është mbyllur me shpalljen e fituesit, sipas procedurës së lëvizjes paralele.

Me kërkesën e datës 06.10.2023, ankuesja ka shprehur interesin për pozicionin e shpallur vakant "Shef i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Trajtimeve", Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në lidhje me këtë kërkesë Këshilli i Lartë Gjyqësor, është shprehur se: *"Referuar VKM-së nr.242, datë 18.03.2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar, Kreu III, pika 2 c, "Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për procedurë janë: c)- të ketë të paktën vlerësimin e fundit "Mirë" apo "Shumë mirë", specifikohet si më sipër cituar se një ndër kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati, është ndër të tjera është dorëzimi i vlerësimit të fundit, ku me "të fundit", aktet nënligjore në fuqi nënkuptojnë vlerësimin e fundit, 6 mujor për periudhën kur konkuron, pra në rastin konkret vlerësimi i fundit i 6 mujor, përkon me periudhën janar-qershor 2023. Ndërsa nga znj. R. I, është depozituar vlerësimi për periudhën korrik-dhjetor 2022.*

Gjithashtu, në shpalljen e pozicionit vakant të publikuar në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor citohet: Mosparaqitja e plotë e dokumentave të sipërcituara, sjell skualifikim të kandidatit". Sqarojmë se, trajtimi i kandidatëve në procedurat e rekrutimit bëhet në mënyrë të barabartë, pa diskriminuar apo favorizuar askënd, pjesë e stafit të institucionit, i cili ka shpallur vendin vakant, ose jo. Mungesa e dokumentacionit përkatës sjell skualifikimin e kandidatit. Pavarësisht, afati i ankimit për plotësimin e dokumentacionit, në mënyrë që të vijonte konkurimin, znj. I, ka shprehur vullnetin e saj të lirë, tërheqjen nga konkurimi."

- **Në lidhje me pretendimin për diskriminim ardhur si rezultat i pozicionimit të ankueses si Specialiste e Administrimit të Prokurimeve sipas Vendimit nr. 38, datë 24.06.2019, si dhe prendimit se klasifikimi në kategorinë III-b ka sjellë rrjedhimisht uljen e pagës.**

Bazuar në aktet e vëna në dispozicion rezultoi se: Në kuadër të ristrukturimit të Institucionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në bazë të Urdhërit nr.39, datë 10.06.2019 është urdhëruar: *Krijimi i Komisionit të strukturimit, në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për kryerjen e procedurës së transferimit, për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit.*

Me shkresën nr. 3195 prot., datë **12.06.2019** me lëndë: *Njoftim për fillimin e procedurës së transferimit*, znj. R. I, në cilësinë e Specialist/ Juristes në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse, është njoftuar lidhur me fillimin e këtij procesi.

Në bazë të shkresës nr.3195/2 prot., datë 24.06.2019, dhe Vendimit nr.38, datë **24.06.2019**, është vendosur transferimi i përhershëm i znj. R. I, në pozicionin e Specialistes së Administrimit të Prokurimeve në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Njoftim i cili i është bërë ankueses në bazë të shkresës nr.3195/3 prot., datë **25.06.2019**.

Trasferimi i mësipërm rezulton të jetë kundërshtuar nga ana e ankueses në bazë të kërkesës të datës **28.06.2019**, me objekt: *Kërkesë për rishikimin e Vendimit nr.38, datë 24.06.2019 "Mbi transferimin e përhershëm të znj. R. I, në pozicionin e Specialistes në Administrimin e prokurimeve në Këshillin e Lartë Gjyqësor"*.

Me shkresën nr. 3195/5 prot., datë 01.07.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka kthyer përgjigje ankueses dhe ndër të tjera ka sqaruar se transferimi është bërë në të njëjtën kategori si nëpunës civil që keni patur në pozicionin e mëparshëm tek ish- ZABGJ-ja, nivel ekzekutiv si dhe me të njëjtin nivel page.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, momenti i marrjes dijeni nga ankuesi mbi sjelljen diskriminuese të pretenduar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, rezulton që në datën **25.06.2019**, ndërsa data e depozitimit të ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është **13.12.2023**. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se momenti i ndodhjes së diskriminimit daton më shumë se 3 (vjet) nga ndodhja e diskriminimit të pretenduar. Njëkohësisht, edhe momenti, i marrjes dijeni mbi diskriminimin e pretenduar, daton më vonë se 2 (dy) vjet nga data e depozitimit të ankesës nr. 264, datë 13.12.2023 pranë KMD-së.

Në nenin 33, pika 4/b, të ligjit 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, përcaktohet se: "4. Ankesa nuk pranohet nëse: b)është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji" dhe pikën 4/dh të tij, ku është parashikuar se: "Ankesa nuk pranohet kur paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet". Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/b të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, ky kërkim i ankuesit nuk mund të pranohet dhe nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e tij.

- **Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shtesë page mbi caktimin nga Këshilli i Lartë Gjyqësor i ankueses si person përgjegjës për zbatimin e Urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm Nr.18, datë 26.03.2021.**

Lidhur me kërkesën për shtesë page në lidhje me caktimin nga Këshilli i Lartë Gjyqësor i ankueses si person përgjegjës për zbatimin e Urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm Nr.18, datë 26.03.2021, "Për një ndryshim në urdhërin 93, datë 27.10.2020 "Për caktimin e personave përgjegjës nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative për Strukturën e Posaçme për regjistrimin administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit", nga ana e ankueses nuk rezultojë të na jetë vënë në dispozicion ndonjë dokument në cilësinë e provës mbi të cilin e pretendon këtë kërkesë.

Ndërkohë Këshilli i Lartë Gjyqësor është shprehur se: *Referuar vendimit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015" Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", i ndryshuar, kreu II, pika 5. "Secili prej organeve përgjegjëse për*

administrimin e formularit të vetëdeklarimit krijon një strukturë të posaçme ose cakton personat përgjegjës për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularit", sqarojmë se me Urdhër nr.18, datë 26.03.2021 "Për një ndryshim në urdhrin nr.93, datë 27.10.2020 "Për përcaktimin e personave përgjegjës nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, për strukturën e posaçme për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr.138/2015" Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" i ndryshuar, në Këshillin e Lartë Gjyqësor", janë përcaktuar 2 (dy) personat përgjegjës për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularit të vetëdeklarimit, një prej të cilave është dhe znj. R.I. Në zbatim të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, pavarësisht detyrave të cilat i ngarkohen nëpunësit civil në mënyrë verbale dhe /ose me urdhër, ai trajtohet financiarisht, sipas pozicionit të punës që mban, apo është emëruar/transferuar në mënyrë të përhershme.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se nëpunësi civil ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e ligjshëm nga eprorët dhe drejtuesit, sipas ligjit, akteve nënligjore dhe rregullave të brendshme të institucionit, zbaton të gjitha detyrat sipas përshkrimit të punës si dhe detyra të tjera që mund të ngarkohen nga eprori në funksion të detyrave funksionale, apo detyrat e dala nga bashkëpunimi ndërsektorial, që nuk përbëjnë shkelje ligjore dhe që nuk çenojnë dinjitetin e punonjësit.

Gjithësesi, për shkak se ankuesja nuk solli ndonjë argument të provueshëm mbi shkelje ligjore të pretenduara, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma "b" të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, parashikohet se: "4. Ankesa nuk pranohet nëse: b)është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji"; Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.

- **Në lidhje me pretendimin për diskriminim gjatë procedurës për përzgjedhjen për pozicionin vakant Këshilltar në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**

Bazuar në shpjegimet e dhëna nga ankuesja, por dhe nga dokumentacioni i dorëzuar prej saj rezulton se ankuesja, ka shprehur interesimin për pozicionin e Këshilltarit në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershëm në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Sipas shpjegimeve të ankueses, në lidhje me këtë kërkesë nga Institucioni nuk i është kthyer përgjigje në lidhje me shkaqet ligjore për mospërzgjedhjen e saj në këtë pozicion.

Por nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion me shkresën nr.6611/1 prot., datë 04.01.2024, rezultoi që ankuesja sipas kërkesës të administruar pranë KLGJ-së me nr.3992 prot., datë 13.07.2022, ndër të tjera ka kërkuar sistemimin në pozicionin Këshilltar Ligjor,

Me anë të shkresës nr.3992/1 prot., datë 27.07.2022 në lidhje me këtë ankesë Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka informuar ankuesen se pozicioni i kërkuar prej saj është pjesë e pozicioneve të punës

në shërbimin civil dhe si i tillë zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për nëpunësin civil pra ky pozicion në momentin e shpallur vakant nga institucioni, aplikohet dhe procedohet sipas procedurës konkurruese.

Ndërkohë pozicioni i Këshilltarit në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, është shpallur vakant në datën 25.10.2022. Referuar dokumentacionit të administruar me këtë ankesë rezultoi se ankuesja ka aplikuar për këtë pozicion në datën 27.10.2022.

Referuar shpjegimeve të dhëna më shkresën nr.6611/1, datë 04.01.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka shpjeguar se: Referuar pozicionit të shpallur vakant Këshilltar në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, datë 25.10.2022 në zbatim të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neni 26, pika 1, "Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët ose të mesme drejtuese bëhet, së pari, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe, në rast të mosplotësimit të vendit të lirë, me procedurën e ngritjes në detyrë", sqarojmë se procedura është mbyllur me shpalljen e fituesit, sipas procedurës së lëvizjes paralele.

Sa më sipër, Komisioneri kostaton se nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion mbi procedurën e lëvizjes paralele për të cilën shprehet se është plotësuar pozicioni i shpallur vakant për Këshilltar në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. (sa aplikime ka pasur për këtë pozicion, kriteret e vlerësimit etj..)

Dispozitat ligjore të Ligjit nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil ", të ndryshuar, të cilat sipas ankueses janë shkelur e si pasojë e sanksionojnë si më poshtë vijon:

Neni 19

Klasifikimi

1. Pozicionet e shërbimit civil klasifikohen sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit. Klasifikimi bazohet në përshkrimin e punës të çdo pozicioni.
2. Pozicionet e shërbimit civil ndahen në këto kategori:
 - a) të lartë drejtues;
 - b) të mesëm drejtues;
 - c) të ulët drejtues;
 - ç) ekzekutiv.
3. Secila nga kategoritë, sipas pikës 2 të këtij neni, ndahet në klasa.
4. Nëpunës civilë të kategorisë së lartë drejtuese janë këto pozicione:
 - a) sekretar i përgjithshëm;
 - b) drejtor departamenti;
 - c) drejtor drejtorie të përgjithshme;
 - ç) pozicionet e barasvlershme me tre të parat.

5. Nëpunës civilë të kategorisë së mesme drejtuese janë këto pozicione:

a) drejtor drejtorie;

b) pozicione të barasvlershme me të.

6. Nëpunës civilë të kategorisë së ulët drejtuese janë këto pozicione:

a) shef sektori;

b) pozicione të barasvlershme me të.

7. Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive janë specialistët.

8. Pozicionet e shërbimit civil të kategorisë ekzekutive klasifikohen sipas natyrës së pozicionit në:

a) grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm, që përfshin ato pozicione që kanë të bëjnë me përgjegjësi administrative në të gjitha institucionet e shërbimit civil dhe ushtrimi i të cilave kërkon njohuri të përgjithshme administrative;

b) grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm, që përfshijnë ato pozicione që kanë të bëjnë me ushtrimin e përgjegjësive specifike në një apo disa institucione të shërbimit civil dhe ushtrimi i të cilave kërkon njohuri të posaçme të një profesioni të caktuar apo të ngjashëm me të.

9. Këshilli i Ministrave miraton:

a) klasat e zbatueshme për secilën nga kategoritë;

b) përshkrimin e përgjithshëm të punës për çdo kategori, klasë dhe grupet sipas këtij neni, si dhe grupet e administrimit të posaçëm;

c) kërkesat e përgjithshme për pranimin në çdo kategori, klasë dhe grupet sipas këtij neni;

ç) emërtesën e pozicioneve që bëjnë pjesë në çdo klasë, kategori apo grup;

d) metodologjinë e klasifikimit të një pozicioni në një kategori, klasë dhe grup të caktuar.

Neni 26

Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese

1. Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët ose të mesme drejtuese bëhet, së pari, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe, në rast të mosplotësimit të vendit të lirë, me procedurën e ngritjes në detyrë.

2. Këto procedura organizohen nga njësia përgjegjëse, për një ose disa pozicione të lira të ngjashme, bazuar në parimin e përmendur në nenin 20 të këtij ligji.

3. Mund të aplikojnë për procedurat, sipas pikës 1 të këtij neni:

a) nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për vendin/vendet e lira nëpërmjet lëvizjes paralele;

b) nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse, të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, nëse plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira, nëpërmjet ngritjes në detyrë.

4. Përrjashtimisht, Këshilli i Ministrave, për institucionet e administratës shtetërore dhe organi kompetent për institucionet e pavarura mund të vendosë që procedura e plotësimit të vendeve të lira për kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin/vendet e lira. Në çdo rast plotësimi i vendeve të lira në këtë kategori nuk mund të kalojë 20 për qind të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarik.

5. Konkurrimi zhvillohet në dy faza:

- a) verifikimi paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për vendin/vendet e lira;
- b) vlerësimi i kandidatëve.

6. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga komiteti i pranimit, që ngrihet nga njësia përgjegjëse.

7. Në përfundim të vlerësimit, komiteti mund të vendosë:

- a) përzgjedhjen e kandidatit që është renditur i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 për qind të pikëve; apo
- b) përfundimin e procedurës pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët nuk ka marrë të paktën 70 për qind të pikëve.

8. Nëse vendi i lirë nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së parashikuar në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, nëse është e nevojshme, mund të zbatohet procedura e transferimit të përkohshëm në interes të institucionit, sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 48 të këtij ligji.

9. Këshilli i Ministrave miraton kushtet dhe procedurën e hollësishme për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese.

Neni 41

E drejta e informimit dhe ankimit

1. Nëpunësi civil ka të drejtën të informohet për fillimin e çdo procedimi administrativ dhe për çdo vendim përfundimtar që ka të bëjë me marrëdhëniet e tij të shërbimit civil.

2. Nëpunësi civil ka të drejtë të kontrollojë dosjen e tij të personelit dhe të kërkojë ndryshimin e të dhënave të saj.

3. Nëpunësi civil ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi, që i cenon të drejtat dhe interesat e tij të ligjshme në marrëdhënien e shërbimit civil.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 142, datë 12.03.2014 "*Për përshkrimin dhe Klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavaruara*", i ndryshuar.

II. KLASIFIKIMI

5. Klasat e zbatueshme për secilën kategori, si dhe emërtesat e pozicioneve të punës që i përkasin secilës klasë të jenë, si më poshtë vijon:

Kategoria I - Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues

Klasa Emërtimi i pozicionit

1 Sekretar i Përgjithshëm në Këshillin e Ministrave, Presidencë, Kuvend dhe institucione të pavarura kushtetuese.

2 Sekretar i Përgjithshëm në ministritë e linjës, institucionet e pavarura të krijuara me ligj, njësitë e qeverisjes vendore/ drejtor departamenti/titullarë të institucioneve në varësi të Kryeministrit apo ministrave të linjës.

3 Sekretar i Përgjithshëm në njësitë e qeverisjes vendore, drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme në Kryeministri, ministritë e linjës, institucionet e pavarura të krijuara me ligj, njësitë e qeverisjes vendore/titullarë të institucioneve në varësi të Kryeministrit apo ministrave të linjës.

Kategoria II - Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues

Klasa Emërtimi i pozicionit

1 Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme në njësitë e qeverisjes vendore, drejtor drejtorie në Kryeministri, ministritë e linjës, institucione të pavarura të krijuara me ligj, titullarë të institucioneve në varësi të ministrave të linjës, drejtor drejtorie në institucionet në varësi të Kryeministrit apo ministrave të linjës.

2 Drejtor drejtorie në institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave, ministrave të linjës, njësi të qeverisjes vendore.

Kategoria III - Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues

Klasa Emërtimi i pozicionit

1 Shef sektori i nivelit A.

2 Shef sektori i nivelit B.

Kategoria IV – Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive

Klasa Emërtimi i pozicionit

1 Specialisti nivelit A.

2 Specialist i nivelit B.

3 Specialisti nivelit C.

4 Specialisti nivelit D.

6. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për administratën publike, përcakton pozicionet e barasvlefshme për secilën nga klasat e nivelit të lartë drejtues, të mesëm drejtues dhe të ulët drejtues.

7. Vlerësimi i pozicioneve për rastet e parashikuara në pikën 6 të nënndarjes II të këtij vendimi, bëhet nga Departamenti i Administratës Publike, pas marrjes së kërkesës nga ministri/institucioni i pavarur. Departamenti i Administratës Publike ia përcjell vlerësimin ministrit përgjegjës për administratën publike për propozimin e mëtejshëm në Këshillin e Ministrave.

8. Përshkrimi i përgjithshëm i punës, si dhe kërkesat për pranimin në çdo kategori dhe klasë përcaktohen në lidhjen 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Nga verifikimi i bërë nga ana e Komisioneri në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, rezultoi se në shpalljen e datës 25.10.2022³, është njoftuar shpallja e konkurimit për vendin e lirë në shërbimin civil, si Këshilltar në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë, për kategorinë e mesme drejtuese (të dy procedurat janë zhvilluar në të njëjtën kohë).

³ <https://klgj.al/2022/10/n-j-o-f-t-i-m-per-shpallje-konkurimi-per-vend-te-lire-pune-ne-sherbimin-civil-nepermjet-procedures-se-levizjes-paralele-dhe-te-ngritjes-ne-detyre-per-kategorine-e-mesme-drejtuese-4/>

Në shpalljen zyrtare të datës 25.10.2022 për vendin e lirë si Këshilltar në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, janë vendosur kriteret përkatëse, si mëposhtë:

I. Për lëvizjen paralele kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunës të së njëjtës kategori, nga të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

II. Kushtet minimale, që kandidati duhet të plotësojë për vendin e lirë, sipas procedurës për lëvizje paralele, janë:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda të njëjtës kategori (Kategoria e Mesme Drejtuese, II-b);

II. Konukrimi, nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

(Në rast se pozicioni është shpallur, në përfundim të procedurës paralele, nuk është plotësuar, pra rezulton i lirë, atëherë është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të internetit, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nga data 24.11.2022⁴)

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunës të një kategorie paraardhëse, nga të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil, që plotësojnë kushtet minimale për ngritje në detyrë dhe kërkesat e posaçme, për vendin e lirë.

II.1. Kushtet minimale, që kandidati duhet të plotësojë për vendin e lirë, sipas procedurës së ngritjes në detyrë, janë si më poshtë:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, kategoria e ulët drejtuese (me dokument nga institucioni), ose të barazvlefshme me to.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për konkurim nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, do të marrin informacion në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke filluar nga data 24.11.2022, për fazat e mëtejshme që i përkasin kësaj procedure konkurimi.

Sa më sipër, referuar informacionit të administruar nga KLGJ, rezulton që pozicioni Këshilltar në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, klasa e pagës II-1, klasifikohet në kategorinë e mesme drejtuese.

Në zbatim të përcaktimeve ligjore të parashikuara në ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neni 26, pika 3, specifikohet se për procedurën e ngritjes në detyrë mund të aplikojnë nëpunësit civil të një kategorie paraardhëse. Referuar kriterëve të vendosura në shpalljen për konkurim për Këshilltar në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (*pozicion i nivelit të mesëm drejtues*), është parashikuar që mund të aplikojnë për ngritje në detyrë nëpunësit e kategorisë së ulët drejtuese, ndërkohë Znj. I, në momentin e aplikimit dhe aktualisht mban pozicionin specialist, në Sektorin e Administrimit të Prokurimeve, pozicioni i kategorisë ekzekutive.

⁴ <https://klgj.al/2022/10/n-j-o-f-t-i-m-per-shpallje-konkurimi-per-vend-te-lire-pune-ne-sherbimin-civil-nepermet-procedures-se-levizjes-paralele-dhe-te-ngritjes-ne-detyre-per-kategorine-e-mesme-drejtuese-4/>

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se në lidhje me kriteret e vendosura për këtë pozicion vakant nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, është cilësuar si kriter që aplikanti duhet të ishte nëpunës civil i konfirmuar i kategorisë së ulët drejtuese, ndërsa ankuesja i përket kategorisë ekzekutive.

Në lidhje me moskthimin e një përgjigje zyrtare në lidhje me shkaqet e skualifikimit të saj nga ky pozicion, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, në çdo shpallje të bërë nga institucioni sqarohet se kandidatët që aplikojnë për konkurim, do të marrin informacion në faqen zyrtare të institucionit.

Në këto kushte ankuesja në cilësinë e palës së interesuar për faktin e mosvijimit të kësaj procedure me atë të ngritjes në detyrë si dhe plotësimin e vendit vakant nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, kishte mundësinë të informhej në faqen zyrtare të internetit të institucionit por dhe në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ankuesja nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm në lidhje me moskandidimin dhe të mosinformimit në lidhje me këtë procedure.

- **Në lidhje me pretendimin për diskriminim për mospagesë shtesë në page për përfitimin e gradës shkencore "Doktor".**

Bazuar në shpjegimet e dhëna nga ankuesja, por dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, rezultoi se:

Me kërkesën e administruar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr.3992 prot., datë 13.07.2022, nga ankuesja është kërkuar shtesë page për fitimin e gradës shkencore "Doktor". Me shkresën nr.3992/1 prot., datë 27.07.2022 nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor është kthyer përgjigje, ku bëjnë më dije se:

“Bazuar në VKM nr. 187, datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të nëpunësve civil/nëpunësve, zëvendministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavaruara, institucionet në varësi të kryeministrit, institucione në varësi të ministrive të linjës dhe administratës së prefektit" i ndryshuar, shtesa për kualifikim në shërbimin civil aplikohet për kategoritë e pagave nga kategoria II-b ose më lart, si dhe miratohet nga institucionet e pavaruara nga njësi e manaxhimit të burimeve njerëzore kur kualifikimi, grada apo titulli shkencor, përputhen me përshkrimin e punës.

Me vendimin nr.38, datë 24.06.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, jeni transferuar në pozicionin Specialiste e Administrimit të Prokurimeve, në Sektorin e Administrimit të Prokurimeve, në Drejtorinë e Shërbimeve Administrative, në Departamentin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me kategori page III-b.”

Dispozitat ligjore të Ligjit nr.35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe pagës bazë minimale në shkallë vendi", të cilat sipas ankueses janë shkelur e si pasojë e sanksionojnë si më poshtë vijon:

Neni 2

Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton institucionet dhe organet që kanë të drejtë të propozojnë dhe të miratojnë:a) paga, trajtime të tjera financiare dhe përfitime për të punësuarit e institucioneve të administratës publike.

Neni 3

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Institucione të administratës publike" janë institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, njësitë e vetëqeverisjes vendore, njësitë e fondeve speciale dhe ndërmarrjet shtetërore me kapital mbi 50 për qind shtetëror.
2. "Institucione të administratës shtetërore" janë Kryeministria, ministritë, institucionet në varësi të Kryeministrit apo ministrave, Forcat e Armatosura, përfaqësitë diplomatike jashtë vendit, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve, agjencitë autonome dhe administrata e prefektit.
3. "Institucion i pavarur" ka të njëjtin kuptim sipas ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar.

Neni 6

Organet kompetente

Në Republikën e Shqipërisë kanë kompetencë për caktimin e pagës, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve, sipas përkatësisë:

- a) Kuvendi;
- b) Këshilli i Ministrave;
- c) këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore;
- ç) organet kolegjiale drejtuese të njësive të fondeve speciale;
- d) organet kolegjiale drejtuese të ndërmarrjeve shtetërore me kapital mbi 50 për qind shtetëror;
- dh) organet kolegjiale drejtuese të institucioneve të pavarura apo të institucioneve të administratës shtetërore, në rastet kur këto institucione financohen pjesërisht apo tërësisht nga fonde të tjera, të ndryshme nga ato të buxhetit të shtetit, dhe kur kjo kompetencë është përcaktuar shprehimisht në ligjin e krijimit, organizimit dhe funksionimit të tyre.

Ligji nr. 9584, datë 17.7.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj" i ndryshuar:

Neni 1

1. Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i mënyrës së përcaktimit të pagave, shpërblimeve dhe strukturave e organikave të institucioneve kushtetuese e të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, si dhe përcaktimi i rregullave për pagat dhe strukturat për disa institucione të tjera të pavarura dhe disa funksione të larta shtetërore.

2. Dispozitat e krerëve III, IV, V dhe VI të këtij ligji janë të zbatueshme edhe për Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, Gjykatën e Lartë dhe Prokurorinë e Përgjithshme.

3. Pagat e punonjësve të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, që nuk rregullohen në këtë ligj, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji organik për krijimin e tyre.

Neni 9

1. Pagat dhe shpërblimet e nëpunësve civilë/nëpunësve të institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, nga niveli sekretar i përgjithshëm deri në specialist, janë të njëjta me pagat dhe shpërblimet e nëpunësve civilë në ministritë e linjës, sipas përcaktimit të Këshillit të Ministrave, me përjashtim të pagës për sekretarët e përgjithshëm pranë Presidentit të Republikës dhe Kuvendit, të cilat janë të njëjta me pagën e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave.

VKM nr. 187, datë 08.03.2017 "*Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të nëpunësve civil/nëpunësve, zëvendministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucione në varësi të ministrive të linjës dhe administraës së prefektit*" i ndryshuar, ka parashikuar se:

c) Shtesa për kualifikim (kolona 4), për nëpunësit në pozicionet “Sekretar i Përgjithshëm”, “Anëtar i Organeve Kolegjiale drejtuese me kohë të plotë të institucioneve të pavarura, të përcaktuara në pikën

1/1, të këtij vendimi”, “Drejtor departamenti”, “Drejtor i përgjithshëm”, “Drejtor drejtorie dhe pozicionet e veçanta të punës, të kategorizuara në kategorinë II-b ose më të lartë, sipas këtij vendimi, në institucionet e përcaktuara në pikën 1/1, të këtij vendimi”, “Titullar dhe zëvendëstitullar i institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit apo ministrave të linjës”, “Prefekt”, “Nënprefekt”, si dhe funksionarët politikë “Zëvendësministër” e anëtarë të kabineteve, përfitojnë shtesën për kualifikimin, gradën apo titullin shkencor, të përcaktuar sipas lidhjes nr. 2/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Kriteret e përfitimit të shtesës janë:

- Kjo shtesë jepet kur kualifikimi, grada apo titulli shkencor, përputhen me përshkrimin e punës së nëpunësit, por pas miratimit, rast pas/Qendrën Stërvitore/Kompani në Forcën Detare, Baza Ajrore/Shërbimin Meteorologjik Ushtarak/ rasti, nga Departamenti i Administratës Publike, për Kryeministrinë, aparatet e ministrive të linjës, institucionet qendrore/rajonale vendore në varësi të

Kryeministrit, institucionet qendrore/rajonale vendore në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit, si dhe nga njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore, për institucionet e pavarura.

Sa më sipër, Komisioneri bazuar në fakte dhe prova vlerëson se ankuesja nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm në lidhje me mospërfitimin e shtesës në pagë për gradën shkencore "Doktor", për sa kohë që nuk është parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- **Në lidhje me pretendimin për diskriminim mbi ndryshimin e kategorisë dhe si rrjedhojë e pagës në strukturën organizative të KLGJ-së, nga paga III-b në pagën IV-I, duke pësuar ulje në pagë si specialist i Administrimit të Prokurimeve.**

Bazuar në shpjegimet e dhëna nga ankuesja, por dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, rezulton se:

Në zbatim të ligjit 34/2023 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9484, datë 17.07.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavaruara, të krijuara me ligj" i ndryshuar, si dhe VKM-së nr.325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturave të pagave, niveleve të pagave dhe shtesa të tjera mbi pagë të Zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, Prefektit, Nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve të Administratës publike", lidhja7/2/b, specifikohet se pozicioni specialist (kategoria ekzekutive) III-b është i barazvlefshëm me klasën e pagës IV-I.

Me vendimin nr.433, datë 24.07.2023 "Për një ndryshim në vendimin nr.157, datë 20.04.2022 "Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor", Këshili i Lartë Gjyqësor ka miratuar strukturën duke pasqyruar klasën e pagave të reja, sipas VKM-së së sipërcituar.

Referuar zbatimit të akteve të mësipërme ankuesja e cila mbante pozicionin ekzekutiv dhe ishte klasifikuar me parë në kategorinë e pagës III-b, është klasifikuar me zbatimin e akteve të reja ligjore kategoria IV-I (Përsëri niveli ekzekutiv)

Në bazë të ankesës të administruar në KLGJ me nr.5382 prot., datë 17.10.2023 ka kundërshtuar ndryshimin e kategorisë, pagimin e diferencave të pamarra nga rritja e fundit e pagave, riklasifikimin e drejtë të pozicionit të punës dhe kategorisë në pagë në strukturën organike të KLGJ-së.

Me shkresën nr.5382/1 prot., datë 31.10.2023 Drejtoria e Burimeve Njerëzore, pranë KLGJ-së, ka kthyer përgjigje si më posht vijon: "Në vlerësimin e kundërshtimeve të tua në lidhje me ndryshimin e kategorisë së pagës, në vlerësimin tonë ky pretendim nuk qëndron, pasi vendimarrja e KLGJ është tërësisht e bazuar në ligj dhe aktet e dala në zbatim të tij. Në zbatim të ligjit 34/2023 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9484, datë 17.07.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e

institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavaruara, të krijuara me ligj" i ndryshuar, konkretisht nenit 6 organet kompetente dhe nenit 8 kompetencat e Këshillit të Ministrave, është përcaktuar se: Këshilli i Ministrave miraton elementët përbërës të pagës bruto mujore dhe vlerën për çdo element të pagës bruto mujore për të punësuarit në institucionet e administratës publike. VKM nr.325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturave të pagave, niveleve të pagave dhe shtesa të tjera mbi pagë të Zëvendministrit, funksionarëve të kabineteve, Prefektit, Nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve të Administratës publike" kreu II, lidhja nr.1, për institucionin e KLGJ-së , është përcaktuar në lidhjen nr.7/2/b."

Sa më sipër, nga verifikimi i akteve të vënë në dispozicion nga palët në proces rezultoi që ankuesja pavarësisht emërtimeve "Jurist/Specialist" që ka patur në strukturat respektive pavarësisht ndryshimit dhe ristrukturimeve në kohë ka rezultuar që ka qenë niveli ekzekutiv.

Nuk rezultoi e provuar që të ketë qënë e emëruar në nivel drejtues i ulët/i mesëm, pavarësisht emërtesave/kategorizimeve në numër që ka patur niveli ekzekutiv në strukturat respektive dhe për sa kohë është ai nivel dhe paga korespondon në propocion me nivelin.

Sqarojmë se ndryshimi i kategorive/niveleve të nëpunësve civil në çdo rast bëhet sipas procedurave të parashikuara në Ligjin "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe akteve të dala në zbatim të tij.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ankuesja nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm në lidhje me moskandidimin dhe të mosinformimit në lidhje me këtë procedure.

- **Në lidhje me pretendimin për diskriminim gjatë procedurës për përzgjedhjen për pozicionin vakant Shef i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve për Administratën), në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, në Departamentin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve administrative, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**

Bazuar në shpjegimet e dhëna nga ankuesja, por dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, rezultoi se:

Nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor në faqen zyrtare të institucionit në datën 29.09.2023 është bërë njoftimi "Për shpalljen konkurimi për vend të lirë pune në shërbimin civil, nëpërmjet procedurës së lëvizje paralele dhe të ngritjes në detyrë, për kategorinë e ulët drejtuese", për pozicionin Shef i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve për Administratën (Kategoria e ulët drejtuese, III-1), në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, në Departamentin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nga ana e ankuese znj. R. I, me kërkesën e datës 06.10.2023, është aplikuar për ngritje në detyrë, nga ku rezulton e skualifikuar për të vijuar këtë procedurë.

Referuar e-mailit të datës 27.10.2023, dërguar ankueses nisur nga adresa: burimenjerzore@klgj.al, me lëndë: “Mbi rezultatet e verifikimit paraprak”, është njoftuar se nuk përmbush një prej kushteve minimale në njoftimin për shpallje për konkurim, si më poshtë:

“- Ju nuk keni depozituar vlerësimin e fundit të rezultateve në punë, më konkretisht ju keni depozituar formularin e vlerësimit të rezultateve në punë periudhën korrik-dhjetor 2022. Nisur nga fakti se vlerësimi i rezultateve në punë është proces që përsëritet çdo 6 muaj brenda vitit kalendarik, aktualisht, vlerësimi i fundit i rezultateve në punë përkon me periudhën janar-qershor 2023.

Për shkak të mospërmbushjes së një prej kushteve minimale dhe mosparaqitjes së plotë të dokumentacionit, ju jeni skualifikuar dhe nuk mund të vazhdoni konkurimin në fazën tjetër të testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.”

Me e-mailin e datës 30.10.2023 është kthyer përgjigje nga ana e ankueses në lidhje me e-mailin e mësipërm, ku është kundërshtuar dhe se ka pretenduar ndër të tjera se skualifikimi ka qenë i padrejtë dhe diskriminues. Gjithashtu është shprehur se në shpalljen e paraqitur nga institucioni nuk është specifikuar periudha e vlerësimit të fundit dhe vlerësimi paraprak i bërë nuk qëndron dhe është i gabuar. Njësia përgjegjëse i ka të administruara në dosjen personale të nëpunësit të gjitha vlerësimet e punës sipas periudhave që ato janë kryer. Nje kopje e të cilave ndodhet në protokollin e institucionit.

Me emailin e datës 30.10.2023 është kthyer përgjigje nga ana e institucionit me arsyetimin e njëjtë të emailit të mëparshëm, duke specifikuar që skualifikimi ka ardhur si mungesë e vlerësimit të punës, si një kriter bazë i kërkuar në lidhje me këtë procedurë.

Në lidhje me këtë skualifikim nga znj. I, është depozituar dhe ankesa e datës 30.10.2023, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr.5674 prot., datë 30.10.2023, ku i ka qëndruar argumentave të njëjtë si në korrespondencën me e-mail. **Ndërkohë po në këtë ankesë ka shprehur vullnetin për tu tërhequr nga konkurimi dhe njëkohësisht ka kërkuar kthimin mbrapsht të dokumentacionit.**

Me shkresën nr.5674/1 prot., datë 02.11.2023 nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, është kthyer përgjigje ankesës së mësipërme ku është bërë me dije:

“Referuar VKM nr.42, datë 18.03.2015 " Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar, Kreu III, pika 2 c" Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë: c) të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”; specifikohet si më sipër cituar se një ndër kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati është ndër të tjera dhe dorëzimi i vlerësimit të fundit, ku me "të fundit", aktet nënligjore në fuqi nënkuptojnë vlerësimin e fundit, 6 mujor për periudhën që konkuron, pra në rastin konkret

vlerësimi i fundit përkon me atë të periudhës janar-qershor 2023. Ndërsa nga ana juaj është depozituar vlerësimi për periudhën korrik-dhjetor 2022.

Në shpalljen e pozicionit vakant të publikuar në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor citohet: "Mosparaqitja e plotë e dokumentave të sipërcituara, sjell skualifikimin e kandidatit".

Ju sjellim në vëmendje se trajtimi i kandidatëve në procedurat e rekrutimit bëhet në mënyrë të barabartë, pa diskriminuar ose favorizuar askënd, pjesë e stafit të institucionit, i cili ka shpallur vendin vakant, ose jo. Mungesa e dokumentacionit përkatës sjell skualifikimin e kandidatit.

Sjellim në vëmendjen tuaj se, referuar VKM- së nr.833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", dosja juaj personale administrohet pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, për të cilën, keni të drejtën e plotësimit/kërkimit/njohjes."

Korespondeca në lidhje me pretendimet mbi skualifikimin e saj nga konkurimi ka vijuar me institucionin dhe me e-mailet e datës 02.11.2023 dhe 03.11.2023.

Fakt tjetër i kostatuar është se referuar vlerësimit të punës për periudhën janar-qershor 2023 të vënë në dispozicion nga ankuesja rezultoi që vlerësimi i saj është bërë nga institucioni në datën 03.07.2023 dhe është nënshkruar prej ankuses.

Dispozitat ligjore të Ligjit nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil ", të ndryshuar, të cilat sipas ankuses janë shkelur e si pasojë e sanksionojnë si më poshtë vijon:

Neni 26 i sipërcituar

"Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese"

Neni 32

Pranimi i nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.

1. Pranimi në kategorinë e nëpunësve civilë të lartë drejtues në institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore bëhet me konkurrim të organizuar për një apo disa pozicione të lira dhe është i hapur për nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese. Përjashtimisht, titullari/organi vendimmarrës i institucionit mund të vendosë që procedura e pranimit të jetë e hapur edhe për kandidatët e tjerë, jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në këtë kategori, por në asnjë rast ky numër nuk mund të jetë më shumë se 15 për qind të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kategorisë së lartë drejtuese për atë institucion. Çdo emërim i kategorisë së lartë drejtuese, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në këtë ligj, është absolutisht i pavlefshëm.

2. Konkurrimi organizohet në përputhje me nenin 20 të këtij ligji nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit.
3. Këshilli i Ministrave miraton rregullat e hollësishme për krijimin, përbërjen dhe veprimtarinë e komiteteve të përhershme të pranimit, si dhe rregullat e hollësishme për procedurën e pranimit dhe vlerësimin e kandidatëve.

VKM nr.242, datë 18.03.2015 " Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar,

KREU III NGRITJA NË DETYRË

1. Në rastet kur një vend vakant në kategorinë e nivelit të ulët apo të mesëm drejtues nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, njësia përgjegjëse shpall procedurën e ngritjes në detyrë.
2. Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:
 - a) të jetë nëpunës civil i konfirmuar;
 - b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
 - c) të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
 - ç) të plotësojë kushtet e tjera të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil;
 - d) Të përmbushë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.
3. Rregullat për procedurën e lëvizjes paralele, siç parashikohet në pikat 3 deri 7 të Kreut II, të këtij vendimi, do të zbatohen edhe për procedurën e ngritjes në detyrë.
4. Shpallja e procedurës për ngritjen në detyrë botohet të paktën 35 ditë kalendarike para datës së parashikuar për zhvillimin e vlerësimit.
5. Shpallja në portal dhe në faqen zyrtare të DAP-it përmban këto të dhëna:
 - a) pozicionin e punës që është vakant;
 - b) përshkrimin e përgjithshëm të punës për atë pozicion;
 - c) kushtet për ngritjen në detyrë dhe kriteret e veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët;
 - ç) dokumentet që duhet të dorëzohen dhe mënyra e dorëzimit të tyre;
 - d) afatin e dorëzimit i përcaktuar me datë të saktë kalendarike;
 - dh) datën e daljes së rezultateve për fazën e verifikimit paraprak të kushteve minimale të procedurës së ngritjes në detyrë dhe të përmbushjes së kritereve të veçanta të vendit të punës;
 - e) fushën e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen;
 - ë) mënyrën e vlerësimit të kandidatëve;
 - f) mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.
6. Plotësimi i vendeve të lira, me procedurën e ngritjes në detyrë është i hapur për nëpunësit civilë të një kategorie më të ulët në të njëjtin institucion apo institucione të tjera të shërbimit civil.

Dokumentacioni duhet të dorëzohet brenda datës së përcaktuar në shpalljen për vendin e lirë. Kjo datë përcaktohet duke siguruar që afati i dorëzimit të dokumentacionit të mos jetë më i vogël se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes.

7. Vlerësimi i kandidatëve për ngritjen në detyrë realizohet nga Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë (KPND), i cili ka në përbërje 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë vijon:

- a) 1 (një) anëtar nga njësia përgjegjëse, i cili kryeson komitetin;
- b) Për institucionet e administratës shtetërore, 1 (një) anëtar nga institucioni që ka vendin vakant, pjesë e kategorisë së mesme drejtuese, i përcaktuar nga DAP-i. Për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, 1 (një) anëtar i zgjedhur nga titullari midis nëpunësve civilë të institucionit, nëse është e mundur të nivelit të mesëm drejtues;
- c) Eprorin direkt të pozicionit, për të cilin zhvillohet konkurrimi;
- ç) 2 (dy) ekspertë të fushës përkatëse, në varësi të fushës së vlerësimi.

21. Konkurrimi për procedurën e ngritjes në detyrë përfshin dy faza:

- a) verifikimin paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;
- b) vlerësimin e kandidatëve.

22. Njësia përgjegjëse, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të tyre, bën verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kushtet dhe kërkesat e veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

23. Në përfundim të verifikimit, sipas pikës 22 të kreut III të këtij vendimi, kandidatët, të cilët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta të pozicionit të punës, renditen në një listë sipas rendit alfabetik.

24. Lista e përmendur në pikën 23 të kreut III të këtij vendimi administrohet nga njësia përgjegjëse dhe shpallet në:

- a) Faqen zyrtare të DAP-it dhe portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, për administratën shtetërore;
- b) Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit dhe në ambientet e brendshme, për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.

25. Kandidatët, që nuk plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, renditen në një listë të veçantë, në të cilën tregohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Lista administrohet nga njësia përgjegjëse dhe nuk bëhet publike. Kandidatët që nuk janë kualifikuar njoftohen individualisht nga njësia përgjegjëse.

26. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, në përputhje me pikën 25 të kreut III të këtij vendimi, kandidatët që nuk janë kualifikur kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim pranë njësisë përgjegjëse. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se nga ana e institucionit është kryer procedura e njoftimit për arsyet e skualifikimit nga procedura e konkurimit, duke i dhënë të drejtën ankueses që të plotësojë

këtë dokumentacion brenda një afati 5 ditor sikurse është parashikuar në dispozitat e mësipërme ligjore.

Për sa kohë që në kriteret e publikuara në njoftimin "Për shpalljen konkurimi për vend të lirë pune në shërbimin civil, nëpërmjet procedurës së lëvizje paralele dhe të ngritjes në detyrë, për kategorinë e ulët drejtuese", për pozicionin Shef i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve për Administratën, është vendosur si kriter depozitimi i vlerësimit të punës i 6 mujorit të fundit, dhe është përcaktuar që mungesa e tij e skualifikon atë, ankuesja ka patur mundësinë që ta plotësonte.

Gjithashtu brenda afatit 5 ditor të vlerësimit paraprak ankuesja ka shprehur vullnetin e saj për tërheqjen nga konkurimi si dhe kthimin e dokumentacionit të depozituar prej saj për këtë konkurim.

Bazuar në tërësinë e arsytimit të mësipërm si dhe në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se, ankuesja znj. R. I, nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë. Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, ardhur për shkaqet e pretenduara.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga ankuesja znj. R. I, kundër Këshillit të Lartë Gjyqësor me pretendimin për diskriminim për shkak të "*gjinisë*", "*gjendjes familjare, martesore*" dhe për "*çdo shkak tjetër*", është e pabazuar, pasi nuk rezultoi e provuar që punëdhënësi/KLGJ-ja, të jenë shkelur dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses znj. R. I, për shkak të "*gjinisë*", "*gjendjes familjare, martesore*" dhe për "*çdo shkak tjetër*", nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

